



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 6 SHTATOR 2018, TIRANË

PROCESVERBAL

SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI

(Opozita nuk është e pranishme në këtë seance plenare.)
(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 03.09.2018 *(neni 44 i Rregullores)*

2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

3. Akt normativ nr. 1, datë 26.07.2018 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare)

Koha e votimit

4. Të mbartura për votim:

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” *(neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)*

- Projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” *(neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)*

5. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës *(neni 45 i Rregullores)*

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta

Gramoz Ruçi – Të futen mediet brenda.

Seancën e sotme plenare e deklaroj të hapur.

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Kalojmë te miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 03.09.2018. Ka ndonjë vërejtje për procesverbalin? Nuk ka.

Miratohet.

Projektligje dhe projektakte të depozituara në Kuvend nuk ka, përveç atyre që ju njoftova para tri ditëve.

Atëherë, fillojmë me aktin normativ nr. 1, datë 26.07.2018 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018””, sipas nenit 72 të Rregullores. A ka ndonjë pyetje për aktin normativ? Nuk ka.

Sipas nenit 74/1 të Rregullores, fjalën e ka ministri i Financave, zoti Ahmetaj, si nismëtar, pa kufizim kohe.

Arben Ahmetaj – Besoj se reflektimi për këtë akt normativ na fton të gjithëve detyrimisht, edhe sipas traditës, t’u kthehemi ngjarjeve ekonomike jo vetëm të këtij viti, por edhe të viteve të shkuara, që të reflektojmë për të gjitha projektet e së ardhmes, për objektivat dhe pritshmëritë e buxheteve që vijnë në raport me pritshmërinë e qytetarëve dhe të nxjerrim në dritë të vërtetën e të gjitha debateve, me të cilat natyrshëm me emocione opozita në vazhdimësi përballet qoftë me maxhorancën, qoftë me të vërtetën.

Dua të bëj një parashtrim të situatës makroekonomike të viteve të fundit. Rëndom dhe shpeshherë për qytetarët fjalët “situatë makroekonomike” duken si virtualitet. Dua t’u kujtoj qytetarëve se situata makroekonomike është një kërcënim larg syve të kujtdo nga ne dhe duket si përrallë. Ndërkohë, kur ndodh, nuk është më një përrallë, por është një e keqe, është një kolerë, që cenon çdo qenie të gjallë të ekonomisë, mbi të gjitha cenon xhepin e qytetarëve. Është shumë e rëndësishme që t’ju kujtojmë çfarë ndodhi në vitin 1996. Ishte makroekonomia ajo që solli atë zinxhir të këqijash.

Viti 2012 shënoi kulmin e varfërisë në Shqipëri për shkak të keqmenaxhimit dhe në platformë të keqmenaxhimit ishte makroekonomia. Ajo që, fatkeqësisht, varfëroi komshinjtë tanë në Greqi ndodhi për shkak të

keqmenaxhimit të financave publike dhe ishte makroekonomia që ua zbrazti xhepat qytetarëve. Jo pa qëllim jua solla si shembull, sepse shëndetshmëria e financave publike dhe shëndetshmëria makro është në themel të të gjitha planeve. Pra, është një lloj sikur bëhesh gati për një maratonë, ndërkohë që muskujt dhe zemra nuk janë në rregull. Pra, nëse bëhemi gati për të nisur së bashku një maratonë (këtu u referohem të gjitha reformave) dhe nuk e kemi zemrën dhe muskujt të shëndetshëm, të fortë, nuk do të shkojmë dot në finale.

Nga virtualiteti i makroekonomisë, që përmenda këtu, deri te xhepi i qytetarëve, është një përpjekje shumë e madhe. Nëse kjo përpjekje nuk është në drejtimin e duhur, goditja shkon drejtpërsëdrejti te xhepat e qytetarëve dhe tek ekonomia e qytetarëve, por, nëse bëhet mirë, atëherë çdo ditë do të shikojmë përmirësime. Sigurisht që debati se sa afër janë përmirësimet me pritshmërinë, do të jetë një debat i shëndetshëm në vazhdimësi, sepse kjo maxhorancë në finale e ka vëmendjen te qytetari, te mirëqenia e qytetarit, te hallet e përditshme të qytetarit, te zëri i përditshëm i qytetarit, i cili, natyrshëm, kur diskuton për ekonominë, nuk duhet të jetë asnjëherë i kënaqur, pavarësisht se sa përmirësohet ekonomia. Përmirësimi i ekonomisë është në raport me të tashmen, por pritshmëria është detyrim për ata që bëjnë politikën për të pasur në vëmendje të ardhmen e ekonomisë së qytetarëve.

Viti 2018 ka vijuar të konsolidojë trendin përsheptues të ekonomisë shqiptare, i cili ka filluar tashmë që prej vitit 2014. Debati nëse është rritur ekonomia dhe sa është rritur ekonomia, diku është interesant, diku është legjitim, por diku bëhet edhe qesharak. A i mbani mend 2012-ën dhe 2013-ën?! Statistikisht rritja ekonomike ishte 0,5-0,8%. Tani diskutohet që rritja ekonomike me 4,5% është pak. Patjetër që është pak, sepse 4,5% është larg pritshmërisë së qytetarëve, por, sigurisht, e ka lënë pas 0,5% - 0,8%-shin qesharak, ku qytetarët humbën shpresën për të ardhmen dhe paratë e familjes. Atyre iu ripërsëriti i njëjti skenar me figura të njëjta, por me trajektore të ndryshme i skemave piramidale të viteve 1996-1997.

Të dashur qytetarë dhe qytetare,

Është e vërtetë se rritja ekonomike me 4,5% është pak në krahasim me atë që ne presim

dhe në krahasim me atë për të cilën ne po punojmë. Patjetër që kur kalon 3%, qytetarët fillojnë ta ndiejnë; patjetër që zhvillimi nuk është njëlloj; patjetër që pabarazia ka nevojë për më shumë instrumente për t'u reduktuar në të gjithë Shqipërinë, por ne duhet të biem dakord për një gjë: kemi lënë mbrapa skenarin grek. Nuk duhet ta harrojmë asnjëherë këtë gjë, sepse na u deshën 15 vjet e kusur për të arnuar, për të qepur dhe për të zhdukur kolerën e viteve 1996-1997. Prandaj, kur flasim për makroekonominë, shumëkush mund të mos na kuptojë, por me modesti do të desha që të mos harronin kurrë që plagët duan kohë të shërohen. Sot ne i kemi mbyllur ato plagë të hapura dhe i kemi shëruar. Sot ne jemi në garë me pritshmëritë e qytetarëve.

Prodhiimi i brendshëm bruto u rrit me 4,45 % në terma realë në tremujorin e parë të vitit 2018. Ne besojmë, nga të dhënat indirekte të Bankës së Shqipërisë dhe të INSTAT-it, se edhe në tremujorin e dytë do të ruajmë të njëjtin temp. Gjithashtu, besojmë se ky vit do të mbyllet me mbi 4% për të na dhënë një mundësi që të ecim drejt angazhimit që kemi marrë në programin e qeverisë për të arritur mesataren 4,5 -5%.

Të gjithë komponentët e shpenzimeve, të cilët gjeneruan pjesën më të madhe të rritjes ekonomike në tremujorin e parë të vitit 2018, ishin investimet dhe konsumi.

Të dashur qytetarë,

Çdolloj debati intuitiv apo emocional që mund të bëhet këtu, shifrat janë të rëndësishme dhe konsumi ka të paktën 6 ose 7 tremujorë që vetëm rritet. Në të njëjtën kohë investimet në terma realë janë rritur në 5,4-5,5%.

Për sa i përket legjendës urbane se çfarë po ndodh me TAP-in apo çfarë po ndodh me Devollin, po jua them: ne kemi nevojë për më shumë investime, ne kemi nevojë që të jemi një ekonomi më e hapur, ne kemi nevojë që të jemi konsumatorë dhe një ekonomi me më shumë pritshmëri ndaj vetes sonë për të pranuar, pa asnjë paragjykim, çdolloj investimi të huaj, sepse vetëm kështu ne do të kemi mundësi të ruajmë ritmin. Pra, pyetjes së legjendës urbane se çfarë po ndodh me investimet e huaja po i përgjigjem sot me statistika dhe me të dhëna operative të Bankës së Shqipërisë.

Tremujori i parë arriti nivelin rekord 284 milionë. Tremujori i dytë, sipas të dhënave operative, arriti nivelin e rreth 200-220 milionë

euro investime të huaja. Debat politik "ku janë investimet e huaja, këto i solli Saliu, ato i solli Nano, këto i solli Rama", është qesharak, ekonomia është një.

Sivjet janë të gjitha gjasat që të vendoset rekord: në 6 muaj 500 milionë euro investime të huaja, të cilat janë pak për pritshmërinë, por janë më shumë sesa viti i kaluar. Pra, këtë vit sërish mund të kemi një numër rekord të investimeve të huaja, 1 miliard euro. Inat me shifrat do të hamë, shifrat e opozitës duhet të jenë të zeza dhe shifrat tona duhet të jenë rozë? Shifrat nuk janë as të opozitës, as të maxhorancës, shifrat janë të ekonomisë dhe përkthehen në mirëqenie për qytetarët.

Akoma nuk kam dëgjuar një debat të qenësishëm ndër vite me gjithë mungesën që ka opozita për të gjitha këto çështje që shqetësojnë qytetarët, sepse e gjithë vëmendja e opozitës është se si do ta marrin këta pushtetin mbi hi, mbi shkrumb e mbi flakë. Krimi, droga, krimi, droga. Asnjëri nuk diskuton se çfarë ndodh me pagat, çfarë ndodh me vendet e punës, çfarë ndodh me zinxhirin e vlerës në ekonomi, çfarë ndodh me investimet e huaja, por thonë se këto i solli Saliu.

Shqipëria është ndarë në fragmente, një pjesë është e Meksit, një pjesë është e Nanos, një pjesë është e Saliut, një pjesë është e Ramës, një pjesë është e Majkos, një pjesë është e Metës, kështu e ndajnë këta, ndërkohë që ekonomia është e qytetarëve, Shqipëria është e qytetarëve dhe shifrat nuk janë shifra, por përkthehen në vende pune, përkthehen në zhvillim ekonomik, përkthehen në paga, përkthehen në të ardhura, përkthehen në imazh, eksporte dhe importe. Asnjëherë nuk e kemi bërë këtë diskutim.

Pra, në qoftë se biem dakord, për shkak të situatës qoftë në rajon, qoftë në Europë, investimet e huaja mund të kishin një risk të binin, po e përdor në zhargon "Shyqyr që nuk po bien", është e rastësishme se çfarë imazhi kemi në kontributin e Shqipërisë qoftë djathtas, qoftë majtas. Ky është diskutimi, ndërsa diskutimi që këtë e solli Saliu e këtë e solli Rama kthehet në diskutim qesharak, sepse pjesa kush e solli nuk i duhet fare qytetarit, se nuk i intereson. Qytetari kërkon ta shikojë të përkthyer në vende pune dhe në vende pune të paguara mirë, kjo është sfida jonë sot, të kemi vende pune të paguara mire. Për vendet e punës do të flas pak më vonë.

Ndërkohë, sektorët realë si industria kanë performuar mirë. A e dini që më në fund kemi bërë një kthesë në industrinë e përpunimit të mineraleve? Ju e dini, të nderuar kolegë, të gjithë qytetarët e dinë që industria e përpunimit të mineraleve u shkatërrua dhe i gjithë minerali eksportohej. Ndërsa sot, me një politikë të kujdesshme fiskale (mos e harroni që rentën e përpunimit e kemi bërë gjysmën e rentës për eksportin, pra t'ua them qytetarëve pak më thjesht, ai që eksporton mineral paguan 6% rentë, ai që e dërgon mineralin, kromin, nëse doni, te përpunimi vendas në industri moderne me kreditime, me kapital vendas dhe me kreditim të huaj paguan 3% rentë) kemi bërë të mundur që më në fund ta rikthejmë zinxhirin e përpunimit në industrinë përpunuese të mineraleve. Ku janë investimet, ku janë investimet? Këta janë njerëzit, këto janë frymët e gjalla, këto janë mendjet, këto janë investimet që kanë realizuar këtë rritje të ekonomisë. Industria është 20% në rritje. E rastësishme është kjo? Çfarë ka ndodhur? Jo, nuk është e rastësishme, është punë zinxhir ndër vite.

A e dini sa kanë ata investitorët në Elbasan që punojnë për atë fabrikën e përpunimit? Kanë 5 vjet. Para 3 vjetësh kam takuar në Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim njerëz të zakonshëm, shqiptarë të zakonshëm, që si milingona atje, në korridoret e asaj banke, prisnin për t'u kredituar. Ja ku janë sot, eksportues të një malli të përpunuar dhe jo të një minerali bruto. Për dijeninë tuaj, si dhe për informacion për qytetarët, vlera e shtuar e një minerali bruto dhe i një produkti të përpunuar ka raste që është edhe 1 me 6 në favor të përpunuarit. Kjo është ekonomia, asgjë nuk bëhet brenda një dite, asnjë nga ne nuk ka arritur të bëjë çudira brenda një dite, kudo, në punë apo në shtëpi.

U rrit tregtia me 3,73%, u rrit bujqësia me 2%. Kjo e fundit ka rritur prodhimin, ka rritur eksportin. A e dini këtë, të dashur miq, të nderuar qytetarë, të dashur fermerë, që para 5 vjetësh përfitonit rimbursim 800 mijë dollarë? Të themi të vërtetën, kjo është shumë e rëndësishme jo për debat politik, por për të mos bërë të njëjtat gabime, për t'u fokusuar te qytetari, sepse ai fermeri atje është një qytetar që kontribuon përditë me punën e tij në fushë, në fermë apo në serra për zhvillimin ekonomik të familjes së tij,

patjetër, por edhe të sektorit të ekonomisë. Rimbursimi para 5 vjetësh ka qenë 800 mijë dollarë. A e dini sa është sot? Sot është 22 milionë dollarë. A është e rastësishme? Jo, nuk është e rastësishme.

A e mbani mend Kryeministrin ditën e parë që ka ardhur? Ai ka thënë se 6%-shi në bujqësi është një gënjeshtër, fermerët nuk kanë marrë asnjë cent. Ne do ta ndërrojmë, megjithëse është e vështirë për buxhetin e shtetit, do ta bëjmë TVSH-në e rimbursueshme për bujqësinë 20%, që ata fermerë dhe ato ferma të përfitojnë 20%-shin real dhe jo 6%-in e gënjeshtërt, që nuk u materializua kurrë.

Këtu bëhet debat politik dhe shajmë njëri-tjetrit, është bërë si shaka e zezë gjithë kohën, na akuzoni nuk keni atë e këtë, kurse ne ju kemi thënë se kemi përgjegjshmëri. Ky korridori këtu është rastësisht ndarësi midis papërgjegjshmërisë, gënjeshtërisë dhe përgjegjshmërisë. A bëjmë ne gabime? Patjetër që bëjmë gabime në punën tonë, kjo nuk diskutohet, por kemi përgjegjshmërinë t'i korrigojmë dhe diferenca më e madhe midis kësaj ane dhe anës tjetër është vëmendja te qytetari. Ata fermerët, që sot kanë marrë 22 milionë dollarë në krahasim me 800 mijë dollarë dikur, janë qytetarë të këtij vendi, të cilët presin nga qeveria që kanë votuar, që nuk është dot kurrë perfekte, sepse në definicion qeveria nuk është dot kurrë perfekte. Qeveria është këtu për t'u kritikuar, edhe për t'u sharë, por diferenca e një qeverie është përgjegjshmëria dhe vëmendja ndaj qytetarit. 800 mijë dollarë me 22 milionë dollarë, nuk ka nevojë t'ju bëj diferencën. A janë mjaft? Jo, nuk janë mjaftueshëm, prandaj kemi bërë fondin e garancisë, prandaj e bëmë nga 10 milionë dikur, nëpërmjet programit të mbështetjes për fermerët, në 26 milionë dollarë, gati dy herë e gjysmë më shumë. Patjetër, dikush këtu, nga e majta, nga kolegët e mi, do të ngrihet dhe do të thotë: "Ministër, nuk janë shumë, sepse është proces". Kemi IPARD-in, prandaj hajdeni të bëhemi të zgjuar, të mençur, punëtorë, të strukturuar t'i ndihmojmë fermerët me instrumentet tona shtetërore, por edhe me gjithë gamën e instrumenteve që lejon tregu që të përfitojmë nga IPARD-i.

Kontributi i IPARD-it është 93 milionë euro me gjithë kontributin e buxhetit të shtetit, diferencë e madhe që, në fakt, nuk na lejon të

mburremi, sepse do të fokusohemi tek *output*-i dhe te produkti. Produkti është se sa kemi bërë të mundur që kjo shumë të konsumohet nga bujqësia, nga sektori dhe të përfitojnë sa më shumë fermerë, sepse ende jemi larg.

E rëndësishme është që në ekonomi edhe perceptimi i aktorëve ekonomikë është përmirësuar dhe mund t'ju them se është përmirësuar mbi mesataren 10-vjeçare. Është shumë e rëndësishme si e perceptojnë konsumatorët, të cilët vazhdojnë të konsumojnë, sipërmarrja, e cila vazhdon të investojë. Është shumë e rëndësishme se si e koncepton dhe e percepton të ardhmen e ekonomisë shqiptare Eurobarometri, dhe për këtë kemi bërë këtu një diskutim. Do të isha shumë i prirur të bëja debat qoftë me maxhorancën, qoftë me opozitën për të dhënat e Eurobarometrit, për përmirësimet dhe perceptimin për ekonominë. Unë ju them po, konsumatorët, qytetarët dhe sipërmarrja kanë një perceptim dhe pritshmëri pozitive për ekonominë.

Hajdeni ta çimentojmë së bashku këtë perceptim për ta kthyer në materializim pozitiv për të ardhmen. Pra, bërja e një debati të tillë këtu do të ishte i shëndetshëm dhe askush prej nesh nuk do të ishte as i turpëruar, as i fyer të dilte ta pranonte: po, këtë e kemi bërë mirë, këtë nuk e kemi bërë mirë, kjo që the vlen, kjo që the merret parasysht, sepse është mendim më i mirë sesa ai që kam unë.

Ne nuk kemi arritur kurrë ta bëjmë me opozitën këtë debat në favor të qytetarëve. Ne si qeveri dhe si maxhorancë vërtet nuk arrijmë dot të bëjmë me të munguarit një debat, por përgjegjshmëria dhe vëmendja ndaj qytetarëve nuk cenohet asnjë sekondë.

Për sa i përket ecurisë fiskale, do t'ju them vetëm tri elemente, sepse besoj se është shumë e rëndësishme ta ndaj me qytetarët atë që po ndodh me këtë rishikim buxheti.

Pikë së pari, të nderuar qytetarë, të dashur kolegë deputetë, nuk i kemi ndryshuar të ardhurat. Të ardhurat nuk janë ulur, por janë ato që kemi parashikuar në dhjetor po këtu, në këtë parlament. E njëjta gjë ndodh edhe me shpenzimet, të cilat nuk i kemi ndryshuar. Çfarë kemi bërë? Kemi rialokuar për të furnizuar projekte që kanë ecur pak më shpejt krahasuar me ato projekte që kanë ecur pak më ngadalë.

Çfarë është e rëndësishme në këtë buxhet? Në këtë buxhet ne kemi rikonfirmuar paketën e solidaritetit për pensionistët dhe për familjet me ndihmë ekonomike. Kemi thënë se çdo vit ne do të kemi paketë solidariteti dhe do të vijmë vit pas viti duke e rritur për ta çuar në atë nivel që kemi premtuar në programin tonë qeverisës, në 7 mijë lekë.

Më lejoni, për shkak të debatit politik, të paraqes edhe një seri shumë të shkurtër shifrash. Sivjet, në fund të vitit, pensionistët do të marrin 33 milionë dollarë nga buxheti i shtetit, paketë solidariteti, 50 mijë lekë të vjetër për person. Dikush mund të thotë: a mjafton kjo? Jo, kjo nuk mjafton! Dikush mund të thotë: kjo është vetëm thela e gjelit apo e mishit për Vitin e Ri. Edhe kështu mund të ishte, por nuk është kështu për dy arsye shumë të rëndësishme, të cilat po i ndaj me ju.

E para, është gjesti se kjo qeveri nuk heq dorë nga paketa e solidaritetit dhe bën përpjekje, sado të vështira, diku me shumë sukses, diku me sukses, diku ndoshta edhe pa sukses, që të mos lërë asnjë qytetar jashtë vëmendjes. A doni t'ju bëj edhe një krahasim? Nuk ia vlen të bëjmë krahasime se sa i kemi mbështetur shtresat në nevojë, por është i rëndësishëm debati politik për t'iu përgjigjur gënjeshtreve të vazhdueshme.

Në 8 vjet, po të doni verifikojeni këtë që jam duke thënë, sepse është e vërtetë, mbaj përgjegjësi zyrtare edhe morale, të qeverisjes së Partisë Demokratike janë dhënë vetëm 4 herë bonuse në fund të viteve elektorale, shuma e të cilave në 5 vjet është 10,3-10,4 miliardë lekë.

Ndërsa ne, në mandatin e parë të qeverisë “Rama”, me gjithë borxhet dhe plagët që na lanë, çdo vit, nga viti 2014 deri në vitin 2018 kthyem mbrapsht si paketë solidariteti te qytetarët 11, 7 miliardë, që do të thotë se kjo qeveri në 4 vjet, pa asnjë influencë elektorale, ka dhënë paketë solidariteti më shumë se ç'kanë dhënë ata në 8 vjet. A është e mjaftueshme? Nuk është e mjaftueshme, madje është larg pritshmërisë.

Gjithashtu, për të prekur realitetin nga vijmë dhe ku jemi, në maj të këtij viti ne kaluam indeksimin e pensioneve me një shumë prej 16 milionë dollarësh dhe plus 33 milionë dollarë që do të jepen bonus në fund të vitit, janë 50 milionë dollarë që ne i kemi shtuar fondit të pensioneve dhe xhepave të pensionistëve. Në fondin për pensionet, i cili, pa përfitimet e

statuseve të ndryshme, është 1 miliard, kryeministri dhe qeveria çdo vit i rrit pensionet me 5%. Nuk është shumë, por moshë e tretë e këtij vendi ka nevojë për më shumë vëmendje. Me modesti do ta them se përgjegjshmëria e kësaj qeverie bëri të mundur që të mos ndodhte ajo që ishte parapërgatitur dhe që ndodhi në vende, si: Serbia ose Greqia, ku u ulën pensionet. Këtu te ne nuk u ulën pensionet, u ul borxhi dhe u rrit përgjegjshmëria ndaj moshës së tretë, ashtu siç u rrit ndaj të gjithë qytetarëve në nevojë.

Ndërkohë, do të vazhdojmë të kemi balancë primare pozitive, që do të thotë se kjo qeveri nuk krijon borxh të ri, madje është e rëndësishme të themi që ka përgjegjshmërinë e plotë të mos krijojë asnjë cent borxh të ri për qytetarët dhe për ata që do të jetojnë nesër në këtë vend, që sot janë 10 - 25 vjeç, por nesër do të marrin frenat e drejtimit të këtij vendi. Kjo qeveri nuk krijon asnjë lekë borxh të ri. Borxhi sivjet shkon me zbritje në 67,5%, dhe kjo qeveri, me operacionet e veta, ka përgjegjësinë të mos e rrisë asnjë cent borxhin, përkundrazi, del në treg me shumë përgjegjshmëri dhe shumë kujdes për të financuar operacionet e veta me kosto shumë të ulët dhe po shlyen borxhin që kemi trashëguar nga këta dhe nga ata që kanë qenë para tyre. Këtë detyrë kemi, kjo nuk është mburrje, por është përgjegjshmëri dhe vëmendje ndaj qytetarëve.

Sa i përket tregut të punës, diskutimi për papunësinë, për punësimin, për rritjen e vendeve të punës është besoj diskutimi më i rëndësishëm që mund të bëjë një klasë politike brenda dhe jashtë parlamentit, kudo që i jepet mundësia. Unë kam sjellë disa statistika, por që sigurisht do t'i shoqëroj me komentet e duhura, diku emocionale diku shumë të thata, por të vërteta në lidhje me tregun e punës. Të gjitha raportet, të cilat nuk dua t'i citoj këtu, thonë se tregu i punës në Shqipëri është përmirësuar dhe për këtë shkak paga reale është rritur, por se sa është rritur do ta trajtoj më vonë.

Tani, do t'u sjell qytetarëve një fakt të vërtetë: në 30 vjet në Republikën e Shqipërisë janë krijuar rreth 700 mijë vende pune, ndërsa në qeverisjen tonë, vetëm në 4 vjet janë krijuar 240-250 mijë vende pune. Pra, rreth 35% e vendeve të krijuara në 30 vjet janë krijuar në 4 vjet. Debatimi është nëse ka papunësi apo jo. Po, ka papunësi dhe kjo është një sfidë.

Sfidë tjetër është edhe rritja e pagës reale për të kaluar në një cilësi tjetër të vendit të punës. Ndërkohë, kur themi se janë krijuar 240 mijë vende pune, nuk e themi për mburrje, sepse nuk do të ishte me vend, por u themi të papunëve (76 mijë që janë të regjistruar, po kaq janë edhe të paregjistruar) e kemi së bashku një shpresë po të vazhdojmë me reformat, sepse ashtu siç krijuam vende pune për këta 240 mijë, ashtu do të krijojmë vende pune edhe për 150-160 mijë të tjerë. Këtu kemi shumë sfida, njëra prej të cilave është sfida demografike. Kryeministri ka marrë iniciativën për të materializuar një politikë strehimi në favor të përmirësimit të strehimit për çiftet e reja me qëllim rritjen demografike. Duke i ndihmuar aq sa mundemi, u themi çifteve të reja se ky është vendi, kjo është pasuria, kjo është ekonomia dhe kjo është financa e vendit, ndaj ta kthejnë mbrapsht atë trend negativ, që po e shoh për herë të parë vendi ndër shekuj, uljen demografike, sepse ky është risku më i madh i ekonomisë, i vendit dhe i integritetit kombëtar.

Rritja demografike nuk është sfidë vetëm e një klase politike, e një qeverie, por është sfidë e të gjithëve. Gjithashtu, sfidë është edhe rritja e cilësisë së vendit të punës dhe ne po ndërmarrim një revolucion për mënyrën e kualifikimit. Shumë shpejt do t'u prezantojmë qytetarëve një paketë për kualifikimin total të të papunëve të regjistruar dhe anëtarëve të familjeve që marrin ndihmë ekonomike. Ky do të jetë një revolucion në reflektim të asaj që ndodhi në Bashkimin Europian vite më parë pas letrës së bardhë të viteve '89-'90 për rikualifikim total të forcës së punës. Atë do të mundohemi ta kopjojmë mirë, natyrisht me pak inovacion, por me ato fonde që kemi. Jam i bindur që po ta bëjmë mirë, me dashuri dhe në funksion të vëmendjes ndaj kësaj shtrese, që është e papunë, besoj se do të kemi rezultate shumë pozitive.

Sot dua, gjithashtu, të jap disa përgjigje për disa akuza.

Të dashur qytetarë, po ndalem në akuzën për shpenzimet e luksit, po futem në bordinë e diskutimeve, këta kanë shpenzuar kaq e aq. Unë marr përgjegjësi për këtë të vërtetë që do t'ju them. Për t'iu përgjigjur gënjeshtres së qëllimshme, kuptohet në funksion të hirit dhe të zjarrit, shpenzimet për periudhën 7-mujore janar-korrik të vitit 2018 për mobilime zyraresh janë planifikuar gjithsej 342 milionë lekë ose 0,6 % e

totalit vjetor të investimeve të brendshme. Për periudhën 7- mujore ato janë realizuar në nivelin faktik vetëm 76 milionë. Këto janë shifrat e Thesarit të Shtetit dhe janë të verifikueshme nga kushdo. Unë mbaj përgjegjësi zyrtare për këto shifra që paraqes ndaj parlamentit, ndaj qeverisë dhe qytetarëve, mbi të gjitha. Ku janë 110 milionë dollarët? Ja, pra një gënjeshtër e qëllimshme. A është kjo nga padituria? Jo, nuk është nga padituria, por është e qëllimshme, është varianti i hedhjes baltë mbi çdo gjë, sipas modelit hidh baltë e baltë se i mbetet ngjyra përjetë. Ndërkohë, shpenzimet për rikonstrukcion, ndërtim zyrash për vitin 2018 janë planifikuar 647 milionë lekë ose 1,17% e totalit vjetor të investimeve të brendshme. Prej 55,17 miliardë janë realizuar vetëm 545 milionë, pra ku janë 110 milionë dollarët? Pse gënjejnë? A e dini se çfarë kanë quajtur makinë luksi? Këta kanë quajtur makinë luksi flotën që ka blerë Agjencia Kombëtare e Ushqimit për të kryer detyrat funksionale kundër informalitetit në sigurinë ushqimore. Po të ishin këtu, duhet të dilnin t'u thoshin qytetarëve se nuk duan t'ia dinë për sigurinë ushqimore, nuk duan të ketë mjete, instrumente në funksion të sigurisë ushqimore dhe çfarëdo që të bëjë AKU-ja e quajnë shpenzim luksi. A mund të quhet makinë luksi një makinë, që bën testime laboratorike? A mund të quhet makinë luksi një makinë që inspektorët e AKU-së i çon në çdo cep të vendit? Jo, është në funksion të sigurisë ushqimore. Nëse e quajnë sigurinë ushqimore luks, atëherë ne e dimë që kemi diferencë shumë të madhe midis asaj që mendojnë ata për vëmendjen ndaj qytetarëve dhe asaj që ne mendojmë për vëmendjen ndaj qytetarëve.

Sa i përket arsimit, ministrja do të flasë vetë për ofrimin e teksteve falas, unë po ju them se janë mbi 190 mijë fëmijë që përfitojnë libra falas. Pse nuk e bëtë ju këtë, apo donit të harxhonit te Rruga e Kombit 1,5 miliardë me 7-fish çmimin e betonit dhe 8-fish çmimin e hekurit? A e shpëton dhënia e librave falas një fëmijë dhe një familje? Po, një lek edhe ia kursyem, por mbi të gjitha kjo tregon se maxhoranca është e vëmendshme përditë ndaj qytetarit, ndaj fëmijës, ndaj prindit, që harxhon për librat dhe, sigurisht, krijon një kulturë të re kursimi, sepse fëmijët do të mësohen ta ruajnë librin. Pra, me miliona dollarë nga buxheti po

injektojmë një kulturë të re, po ndihmojmë fëmijën, familjen dhe tregojmë që kjo maxhorancë u kushton vëmendje të gjitha shtresave.

I harruan 600 mijë shqiptarët e pasiguruar, të cilët ishin lënë në mëshirë të fatit nga ajo qeveri, që sot është në opozitë. Kjo tregon mungesë vëmendjeje ndaj qytetarit, që e la në rrugë.

Ne iniciuam një politikë, e cila sot po jep frytet e veta, por e rëndësishme është që ata 600 mijë qytetarë, megjithëse të pasiguruar, përfitojnë rimbursim të ilaçeve dhe shërbim falas. Paskemi hequr dorë nga shëndetësia falas?! Përkundrazi! E gjithë politika e shëndetësisë falas, me gjithë vështirësitë që kemi aty, me gjithë përmirësimet e domosdoshme që duhet të bëjmë, po jep frytet e veta. A e dini se sa është rritur fondi i rimbursimeve në funksion të kësaj kategorie që është e pasiguruar? 20 milionë dollarë.

Të dashur qytetarë,

Të dashur kolegë, 20 milionë dollarë deri dje paguheshin nga këta qytetarë, ndërsa sot paguheshin nga buxheti i shtetit, ndërkohë po ulim edhe borxhin.

Më tej, çfarë ka bërë qeveria e Edi Ramës me investimet? Edhe këtu fillojnë dhe shahen të gjitha: shahet "Rilindja urbane", shahet llogaria e investimeve, shahet edhe partneriteti publik-privat.

Këtu do ta mbyll, por do ta elaboroj për pak minuta atë që dua të them. Së bashku me partneritetin publik-privat qeveria "Rama 2" do të investojë 3,9 miliardë dollarë, që është rekord në 30 vjet. Pra, në 4 vjet vendos rekord për 30 vjet. Dua të ndalem pak te partneriteti publik-privat. Çfarë është partneriteti publik-privat që këta e demonizojnë?

Të dashur qytetarë, partneriteti publik-privat është një përpjekje e përbashkët e privatit me shtetin, ku riskun kryesor e merr në përgjithësi privati, por thelbi është që të bëjmë të mundur që një shërbim të munguar apo të përkeqësuar në cilësi dhe në sasi ndaj qytetarëve ta sjellim sot të përmirësuar. Po marr disa shembuj. PPP-ja, koncesioni që e demonizojnë, i dializës. Çfarë kanë me njerëzit që vuajnë, që kanë nevojë për dializë? Duan t'i lënë përsëri në skajet e atdheut që të marrin rrugën në 4 të mëngjesit dhe të arrijnë në spitalin e Tiranës në

5 të mëngjesit për të bërë dializën?! Të vuajnë atje dhe në fund të dializës të mendojnë se sa e vështirë do të jetë për të marrë dializën tjetër? Këtë gjë thonë këta?! Kjo është vëmendja?! Po çfarë bëjmë të mundur me dializën, sepse të gjithë fokusohen te procesi, e demonizojnë, e bëjnë koncesionin si një kafshë të egër, të shëmtuar, mitike, që ha para dhe njerëz? Jo! Ta shikojmë në sy të vërtetën. Patjetër që kemi nevojë të përmirësojmë qoftë komunikimin, qoftë transparencën, qoftë procedurat, por në fund e rëndësishme është se çfarë i ofrojmë qytetarit. Hajdeni t'i pyesim ata që fatkeqësisht vuajnë dhe kanë nevojë për dializën, është e mirë apo e keqe? Është e mirë, u ofron shërbim aty ku ata fatkeqësisht vuajnë, dhe pa para, falas.

Po *check up*-i? Pse nuk ka pyetur ndonjëherë opozita se sa qytetarë shqiptarë janë shpëtuar nga *check up*-i? *Check up*-i ka shpëtuar jetë qytetarësh. Doni t'i vini çmim jetës së qytetarëve?! Jo, për ne jeta e qytetarëve nuk ka çmim. Për këtë arsye do ta vazhdojmë ta bëjmë *check up*-in falas. Kemi nevojë për përmirësim, por do të vazhdojmë t'i bëjmë PPP-të në shërbim të qytetarëve, për shërbimin ndaj qytetarëve.

Hajdeni të diskutojmë koncesionin e rrugës së Dibrës! Çfarë thoni ju si opozitë? Ju thoni se 243 milionë euro nuk ia vlejnë të shpenzohen për popullin e Dibrës. Çfarë?! I vini çmim popullit të Dibrës?! Populli i Dibrës ka një jetë i ndarë nga Shqipëria për shkak të terrenit dhe të rrugës dhe 243 milionë euro janë shumë pak. Kujt i thoni ju se aty janë 80 mijë banorë? Aty janë 80 mijë herë 80 mijë shpirta dhe sy shqiptarësh që kanë nevojë të vijnë në Tiranë, ashtu siç vijnë nga Durrësi, nga Shkodra, nga Fieri, nga Korça. E doni Dibrën jashtë Shqipërisë ju?! Për çfarë e doni Dibrën jashtë Shqipërisë, për ato 3 vota që merrni atje?! Po sikur t'ju falim ato 6, mjafton që ata qytetarë të jenë të kënaqur dhe jo thjesht me qeverinë "Rama", por me vëmendjen e kësaj qeverie dhe të kësaj maxhorance ndaj tyre?

Të dashur qytetarë, ky është diskutimi për PPP-të. Hajdeni të diskutojmë se si t'i përmirësojmë standardet! Patjetër! Hajdeni të diskutojmë transparencën! Patjetër! Nuk diskutohet që çdo ditë ka nevojë për përmirësim. Imagjinoni t'i thoni popullit të Dibrës: "Ne sot jo vetëm që nuk kemi para, por edhe nuk bëjmë

asnjë përpjekje për instrumente inovative, që ju të keni një rrugë. Ju hajdeni këtu pas 25 vjetësh, se atëherë do ta ndërtojmë rrugën!". Po për çfarë e kanë votuar këtë qeveri, këtë maxhorancë dhe këtë opozitë, që t'u thoni: "Hajdeni pas 25 vjetësh!". Hallin për 25 vjet ata e dinë vetë dhe nuk ka nevojë t'ua tregojë askush. Ata duan zgjidhje dhe është zgjidhja kjo: koncesioni i Rrugës së Arbrit. Këto janë koncesionet. Janë projekte publike, pronë publike, i mbeten publikut, i mbeten qeverisë, i mbeten bashkisë.

Plehrat e Tiranës i keni parë? Plehrat e Fierit, të Elbasanit? Në turinj do t'ua lëmë shqiptarëve, në kurriz do t'ua lëmë qytetarëve? Është problem për t'u zgjidhur. Si të mbyllim sytë para problemit?! A ka shumë probleme? Ka shumë probleme. Sigurisht, një qeveri lëviz brenda hapësirës së vet dhe bën edhe inovacion, në kuadrin e gjithë menaxhimit të risqeve. Koncesionet janë këto që thashë, janë instrumente inovative. Hajdeni të punojmë bashkë që t'i rregulojmë, të përmirësojmë procedurat! Procedurat janë reflektim i të gjithë procedurave ndërkombëtare. Kush ka ide më të mira, hajdeni t'i ndajmë, por shërbimet dhe investimet ne do t'i bëjmë. Megjithatë nuk i kemi paratë, do t'i gjejmë ato jo duke shpikur, por duke kopjuar mirë. Doni të na ndihmoni të kopjojmë mirë, hajdeni! Do të përfitojnë qytetarët e Dibrës, ata që janë me dializë, ata që kanë nevojë të kontrollohen te mjeku falas, ata që kanë nevojë për libra falas, ata që kanë nevojë t'u hiqen plehrat nga turinjtë, ata që kanë nevojë për rrugën Thumanë-Kashar e të tjera.

E fundit fare. Dua të ndaj me ju një statistikë që nuk e kemi përmendur shpesh dhe besoj se këtu duhet të kërkojmë falje. "Rilindja urbane", ajo që këta e quajnë përmirësimin e sheshit, të rrugës, të ujit, të sokakëve të Gjirokastrës, përmirësimin e sheshit të Kukësit, të Konispolit, që këta e quajnë bojë, sepse këta nuk duan t'ia dinë për qytetarët, është cilësi jete. Për çfarë është votuar kjo maxhorancë?! Gurë-gurë bëhet mur. Nuk po them se po bëjmë çudira, sepse jemi shumë larg asaj që duam, që duhet dhe që kemi ndër mend të bëjmë, por janë harxhuar, shpenzuar dhe investuar 510 milionë dollarë në 4 vjet nga "Rilindja urbane". Ka ndryshuar Belshi, Durrësi, Kukësi, Tropoja, Peshkopia, Korça, Fieri, Gjirokastra, Saranda,

Vlora. Kanë ndryshuar fytyrën. Njerëzit shkojnë më krenarë dhe më rehat në qendrën e qytetit që ishte një llum, ndërsa tani është e pastër, me gurë të pastër, me infrastrukturë modeste, por të strukturuar. Njerëzit tani mendojnë ndryshe për vendin e tyre, për qytetin, për rrugët. Ku shkuan investimet?! 510 milionë dollarë. Këto janë investimet. Janë 642 projekte. Hajdeni ju që mungoni dhe thoni se 642 komunitetet që kanë përfutur nga përmirësimi sado i vogël i cilësisë së jetës së tyre, për ne nuk numërohen. Për ju nuk numërohen, patjetër, sepse doni të aplikoni 7 -fish për çmimin e rrugës, siç e keni bërë, por për këtë maxhorancë, për këtë qeveri, për këtë Kryeministër 642 komunitete janë shqiptarë që kanë nevojë për përmirësimin e jetës së tyre të përditshme.

Këto janë investimet. Shkoni nëpër Shqipëri! Punë kemi sa të doni për të bërë, por kanë ndryshuar qytetet. Pyesni të majtë dhe të djathtë: si ju duket Lushnja? Shumë më mirë sesa ka qenë. Duhet edhe ky kanali, duhet edhe kjo rruga, duhet edhe ky ndryshimi, por sot bëmë sheshin, nesër do të bëjmë ndriçimin. Kjo është logjika në Shqipëri dhe kjo maxhorancë nuk vjen këtu të thotë që ditën që erdhëm ne e bëmë Shqipërinë rozë. Jo! Ditën që erdhëm ne, e shpëtuan Shqipërinë nga skenari grek. Rruga e rritjes së mirëqenies është e gjatë, është e mundimshme, ka nevojë për përgjegjshmëri, për vëmendje ndaj qytetarëve dhe të gjithë punët tona, pavarësisht se nuk janë perfekte, bëjnë një dallim nga ajo që ka ndodhur, janë punë të përgjegjshme, të diskutuara mirë për të rritur mirëqenien e qytetarëve dhe ekonominë e vendit.

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr zonja Hysi.)

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti Ministër!

Në bazë të nenit 74, pika 2 të Rregullores fillojmë diskutimet e deputetëve të regjistruar më parë.

Për aktin normativ kanë regjistruar emrat nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste deputetët: Ervin Bushati, Arben Pëllumbi, Taulant Balla, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Xhevit Bushaj, Ulsi Manja dhe Milva Ekonomi.

Nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dhe Grupi Parlamentar Lëvizja Socialiste për Integrim nuk ka të regjistruar. Në

emër të Grupit Parlamentar të PS-së është regjistruar zoti Anastas Angjeli.

Fjalën e ka deputeti Bushati.

Të përgatitet deputeti Pëllumbi.

Ervin Bushati – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë të Shqipërisë, që po na dëgjoni!

Ekonomia shqiptare ka hyrë në një rreth virtuoze zhvillimi ekonomik, duke marrë parasysh që rritja ekonomike për këtë 3-mujor ka qenë në shifra 4,5 %, që papunësia për herë të parë është ulur në nivelin 12,5%, që investimet e huaja direkte janë rritur mbi 60% se në të njëjtën periudhë të një viti më parë, që deficitet buxhetor është sa gjysma e rritjes ekonomike, është 2% në raport me GDP-në dhe për herë të parë fillojmë të ulim borxhin kombëtar.

Shpeshherë opozita thotë se këto nuk janë të mjaftueshme për Shqipërinë. Patjetër që çdo gjë që bën politika, qeveria, nuk është asnjëherë e mjaftueshme për qytetarët, sepse ndryshe nuk do të kishte as politikë dhe as qeveri dhe qytetarët do të drejtoheshin vetë, por ky rreth virtuoze është shumë më i mbarë sesa rrethi vicioz që na lanë paraardhësit në ekonomi, ku rritja ekonomike ishte pothuajse zero, deficitet buxhetor ishte 4 herë më i lartë, ku borxhi kombëtar ishte në nivele të pakontrollueshme dhe papunësia vetëm rritej. Shqipëria këtë vit ka mbajtur përsëri parametra makroekonomikë dhe një stabilitet financiar shumë të lavdërueshëm nga institucionet ndërkombëtare, të cilat nuk janë partnere me Partinë Socialiste, me qeverinë apo me maxhorancën, po thonë të vërtetën.

Sot ekonomia shqiptare ka disa lajme të mira, që mund t'i ndajmë me qytetarët, për të dhënë edhe një dozë pozitiviteti, jo thjesht për t'i bërë qejfin qeverisjes. Ne në komision patëm shumë diskutime. Për herë të parë kishim një mbledhje normale të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, ku mund të diskutohej, kishte debate, pyetje, reagime edhe nga qeveria, sepse opozita më në fund nuk ishte aty të bërtiste dhe të na bllokonte mbledhjen.

Në radhë të parë, disa sfida që janë për Ministrinë e Financave apo për të gjitha përlllogaritjet në të ardhmen kanë të bëjnë me disa pika që dua të ngre. Ne duhet t'i shikojmë

të gjithë bashkë si sfida për t'u parashikuar, për t'u parandaluar dhe për t'i paraprirë që ekonomia të ketë më të mirën. Edhe në të ardhmen do të ketë mbivlerësim të lekut. Në momentin që leku u forcua, në raport me euron dhe me dollarin, opozita vuri kujën, ashtu siç e ka vënë edhe për 100 raste të tjera, kur ka thënë: "Dështoi shteti, ra qeveria, ra maxhoranca". Maxhoranca 100 herë bie dhe 100 herë ngrihet. Pra, kaq pa vlerë janë kujet e opozitës? Megjithatë, ne duhet të kemi parasysh që në të ardhmen të jemi më të vëmendshëm dhe të parashikojmë apo të projektojmë më mirë projektbuxhetin. Ajo që i mungoi buxhetit në këtë vit ishin fitimet e munguara, që vinin nga vlerësimi i parasë dhe që kishin të bënin me importet.

Shqipëria ka rritje ekonomike. Sa më shumë rritet turizmi, sa më shumë hyn monedha e huaj, sa më shumë ulet papunësia, aq më shumë monedha vendëse, kombinuar edhe me efektet e jashtme të ekonomisë globale, mund të fillojë të forcohet. Në lidhje me këtë duhet të kemi parasysh të jemi më të saktë në projektin e vitit të ardhshëm.

Gjithashtu, duhet të marrim masa të ndihmojmë atë pjesë që preket më shumë, siç mund të jenë eksportet. Kjo bëhet duke ndërhyrë në reformat strukturore, duke i lehtësuar ato me disa sipërmarrje që mund të ketë qeveria dhe maxhoranca, që edhe eksportet të jenë më konkurruese. Patjetër që të gjitha firmat, bizneset dhe sipërmarrjet shqiptare janë të interesuara ta rrisin vlerën e tyre të shtuar në prodhime, të rrisin kapacitetet, të rrisin teknologjinë, të rrisin efikasitetin, si dhe të jenë më konkurrues në treg.

Është ajo që ne kemi thënë gjithmonë, që bizneset shqiptare duhet të dalin në treg me produkte më të sakta, me produkte më të mira dhe me produkte më të përpunuara. Pra, jo thjesht të çojnë lëndën e parë jashtë Shqipërisë.

Gjithashtu, një problem që do të kemi, do të jetë patjetër edhe demografia. Shqipëria nuk ka më ato ritme lindjesh që ka pasur më parë. Duhet parë edhe lëvizja demografike, që patjetër do të tentojë e do të gravitojë drejt qyteteve e zonave urbane. Prandaj, edhe investimet në infrastrukturë duhet të trajtohen me këtë parashikueshmëri e pritshmëri në të ardhmen. Nuk mund të vazhdojmë të ndërtojmë në infrastrukturë, rrugë, linja elektrike, ujësjellës, kanalizime, në zona, të cilat avash-avash do të

fillojnë të afrohen për të krijuar një jetë më të mirë, një treg më të mirë pune afër zonave urbane.

Gjithashtu, duhet të kemi parasysh zhvillimet rajonale e globale. Sot Europa po kalon një periudhë të mirë ekonomike dhe këtë moment duhet ta shfrytëzojmë për të rritur investimet e huaja direkte, pra të bëjmë më shumë lobim për të përmirësuar performancën tonë fiskale. Pra, në qoftë se kemi për të bërë reforma të tjera, le t'i bëjmë në këto momente pozitive, sepse në momentet e krizave ato kanë kosto më të madhe.

Ekonomia europiane është, gjithashtu, në një fazë më të mirë. Ekonomia europiane po kërkon krah pune nga të gjithë vendet, gjë që kuptohet, do të ketë gravitetin e saj në Shqipëri, e këtë po e shohim. Për disa profesione të caktuara ka kërkesë në vendet e zhvilluara si Gjermania, dhe këtë nuk e ndalojmë dot, sepse ka të bëjë me një ekonomi të kombinuar, por ajo që mund të bëjmë është t'i përafrojmë, t'u paraprijmë, pse jo të përgatisim njerëz, por edhe të përpiqemi t'i mbajmë disa profesione dhe të krijojmë vlerë të shtuar në Shqipëri, duke i lidhur në mënyrë kontraktuale shërbimet këtu, në vend që të largohen njerëzit.

Pra, mund të fillojë të orientohej edhe ekonomia me firma, të cilat, jo thjesht kanë një hemorragji që u shkaktohet nga largimi i krahut të punës, por shërbimet të krijohen nga firmat shqiptare, të cilat shkojnë e kontraktajnë në Europë.

Një pikë tjetër që doja të ngrija ka të bëjë me një realitet që po ndodh e zhvillohet në të gjithë Europën, në të gjithë botën: parandalimi i krizave, ngrohja globale, efektet e patjetërsueshme të natyrës, të cilat po ndihen edhe në Shqipëri.

Ky vit ishte për Shqipërinë një vit turistik rekord, dhe kjo është pika e dytë e diskutimit tim. Patjetër që ishim shumë të kujdesshëm në parandalimin e zjarreve. Nuk patëm asnjë aksident, nuk patëm ngjarje të mëdha, por është shumë e rëndësishme që Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë, Ministria e Financave, të fillojnë të kenë plane më të qarta për parandalimin e situatave që kanë të bëjnë me sezona më të nxehta në verë, sepse në të gjithë botën po shikohet dyfishimi i mundësisë së

rritjes së zjarreve, e në të njëjtën kohë edhe parandalimin e përmblyjeve në dimër.

Pra, asnjë gjë nuk duhet të jetë aksident, por duhet të jetë e parashikuar mirë, duhet të ketë plane të sakta, aq më tepër që një sezon i munguar turistik apo qoftë një turist i kthyer, do ta ketë shumë më të vështirë të vijë në Shqipëri, në qoftë se shikon se ka problematika të tilla.

Në fakt, turizmi është pika e dytë për të cilën do të doja të flisja. Shpenzimet e huaja, shpenzimet e turistëve të huaj në Shqipëri kanë qenë 14, 9, mesatarisht 15 % në raport me GDP-në. Pra, është një shifër shumë frymëzuese dhe shumë pozitive. Fakti akoma më pozitiv është se për herë të parë në Shqipëri kemi më shumë shpenzime nga turistë të huaj sesa nga shqiptarët që rikthehen në Shqipëri, të cilët ne me pa të drejtë i quajmë refugjatë apo emigrantë, por që në të vërtetë sot janë qytetarë europianë, me letra e me pasaporta europiane, që vijnë në Shqipëri të tërhequr prej Shqipërisë, por edhe prej familjeve të tyre. Fakti që sot kemi më shumë të huaj që shpenzojnë në Shqipëri, është lajm i mirë për turizmin shqiptar, i cili mund të jetë me të vërtetë një gjenerator i rritjes ekonomike në Shqipëri.

Shqipëria mund të jetojë shumë mirë me turizëm. Një vend i pozicionuar kaq mirë në brigjet e Mesdheut, në mes të Europës, me një popullatë të vogël prej 3 milionësh, mund të jetojë dhe mund të profilizohet shumë mirë në turizëm. Këtë vit kemi parë shumë iniciativa të mira, të cilat e ndihmojnë turizmin. Përgëzoj shumë fushatën *Smile Albania*, që ishte një fushatë e menduar shumë mirë, duke e paraqitur Shqipërinë jo vetëm si një vend të sigurt, sepse Shqipëria është vend i sigurt, gjë që e dimë të gjithë, kurse ata që vijnë nga jashtë janë skeptikë, por edhe një vend që të fal buzëqeshje, të fal edhe kënaqësi, të fal momente relaksi.

Gjithashtu, duhet të kemi parasysh se maxhoranca ka bërë shumë për ta formalizuar e për ta ndihmuar sektorin e turizmit. Ndërmarrja jonë për uljen e TVSH-së, tatimit mbi vlerën e shtuar, nga 20 % në 6%, pra tri herë, ishte një ndërmarrje shumë e rëndësishme, e cila në fakt nuk ishte vetëm për të ndihmuar turizmin, por ishte dhe një marrëdhënie reciproke kontraktuale me operatorët turistikë për të formalizuar sektorin. Ka ardhur momenti që sektori shqiptar i turizmit të formalizohet, e jo vetëm pse na duhet neve për të mbledhur më shumë taksa në

buxhetin e shtetit, kjo s'do shumë mend, se ne për këtë punë jemi, sepse ato do t'u kthehen qytetarëve, por më tepër për të garantuar siguri, standard e cilësi. Një biznes turistik që është i formalizuar, që është në dritë të diellit, që paraqitet në shtet, do të duhet të mbajë patjetër kushte higjienike më të mira, do të duhet të ketë kushte më të mira për turistët e huaj, do të duhet të ketë siguri, standarde, si dhe t'u garantojë atyre një pushim të këndshëm, që ata të rikthehen.

Ne e dimë se çdo i huaj që vjen në Shqipëri, me dashje ose pa dashje, shndërrohet në një ambasador të besimit të mirë për Shqipërinë. Kjo sepse ndihen mirë në Shqipëri, sepse në Shqipëri...

(Bie gongu)

Prandaj duhet të kemi parasysh që të kemi një respekt të dyfishtë, jo thjesht pse e kemi në ndërgjegjen tonë respektin ndaj mikut, por sepse sot ky mik po na sjell edhe këto të ardhura të shtuara në turizmin që lulëzon në Shqipëri.

Prandaj mendoj se këto sfida duhet të jenë diskutimi i vërtetë. Më vjen keq që partia e propagandës apo PD-ja, sepse PD-ja nuk është më Partia Demokratike, por partia e propagandës, mungon sot, kur flitet për çështje kaq të rëndësishme, në një sezon...

(Bie gongu)

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Bushati!

Fjalën e ka kërkuar ministrja Lindita Nikolla. Më pas fjalën e ka ministri Damian Gjinkuri.

Lindita Nikolla – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të kish qenë tejet me vlerë, siç ndodh normalisht në çdo vend demokratik, që ne sot të kishim mundësi të debatonim në lidhje me aktin normativ edhe me kolegët e opozitës. Gjithsesi, pavarësisht se opozita është në të drejtën e vet për të zgjedhur mënyrën se si bën opozitë, vëmendja jonë mbetet jo vetëm për të dëgjuar atë çka ata thonë, por është shumë e rëndësishme për të orientuar gjithë veprimin tonë politik drejt përfituesve të drejtpërdrejtë, që janë qytetarët.

Sot do të doja të ndaja me ju, të dashur kolegë, një moment shumë të rëndësishëm. Falë reformave të ndërmarra gjatë këtyre viteve nga

qeveria “Rama”, janë mundësuar risi në sistemin tonë arsimor; këtë vit, për herë të parë, edhe dhënia e teksteve falas për fëmijët nga klasa e parë deri në klasën e katërt. Unë do të doja të ndaja me ju rrugëtimin tonë për të ardhur deri në këtë moment, edhe pse ky ishte viti më efikas për të mundësuar këtë shërbim të ri në sistemin tonë arsimor.

Më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj përmbledhjen e gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve, shkëputur nga raporti final i konsulencës ndërkombëtare për vlerësimin e kurrikulës në arsimin bazë, lënë ministrit të Partisë Demokratike në janar të vitit 2011.

Kurrikulës së arsimit bazë i mungon një vizion i qartë dhe koherent. Plani mësimor për arsimin bazë është një nga më të ngarkuarit në Europë, pasi përmban një numër tmerrsisht të madh lëndësh. Kurrikulat dhe programet e ndërtuara me të janë qartësisht shumë të mbingarkuara. Objektivat dhe përmbajtjet e programeve janë përshtatur dobët me moshën e nxënësve dhe të kapaciteteve të tyre reale për të përmbushur kërkesat e kurrikulës.

Kurrikula nuk përmbush nevojat dhe interesat e vërteta të nxënësve nga njëra anë, por edhe ato të prindërve e të shkollës nga ana tjetër. Në kuptimin e plotë të fjalës, mungon një qasje e tillë e diferencuar, e cila do të mund të ofronte shanse të barabarta për të gjithë nxënësit.

Për ta vijuar më tej këtë mbingarkesë të kurrikulës, shumica e teksteve janë të mbingarkuar, tekstet janë tepër shkencorë, me një gjuhë tipike akademike dhe me një numër zgjidhjesh pedagogjike shumë të vështira për t'u kuptuar nga nxënësit.

Kjo është pikënisja, mbi bazën e së cilës ne kemi punuar këto katër vjet, duke i dhënë kështu sistemit tonë arsimor një kurrikulë të integruar për çdo fëmijë nga 3-18 vjeç, një kurrikulë të standardeve europiane, të orientuar nga kompetencat, për të cilën bëmë edhe matjen me ekspertizën ndërkombëtare, që prillin e vitit të kaluar deklaroi se kurrikula në të cilën është përfshirë sistemi arsimor shqiptar është një kurrikulë e standardeve të arsimit 2030, është një kurrikulë që mundëson zhvillimin e qëndrueshëm, por sigurisht ka lënë para nesh një sërë detyrash për t'i përmirësuar, për të cilat ne jemi duke punuar çdo ditë.

Ky vit shkollor mundëson që 400 mijë nxënësit e sistemit të arsimit parauniversitar të punojnë pikërisht me kurrikulën e re të standardeve europiane, mbi të cilën janë hartuar programet, planet dhe tekstet shkollore.

Është fakt se në gjithë sistemin tonë arsimor, pa klasën e pestë, në lëndën shkencore nxënësit punojnë me tekstet e Oksfordit, Kembrixhit dhe Pirsonit. Jo vetëm tekstet ndërkombëtare që u përkthyen e u përshtatën janë të një standardi të ri, por edhe tekstet e autorëve shqiptarë janë të reformuara, të një cilësie të re, të lehtësuara dhe të mbështetura në një sitë të hollë standardesh përzgjedhëse.

Lejomëni t'ju them se në lidhje me atë që u nis si reforma e altermtekstit, ne gjetëm në sistem 1310 tekste, me nga 11 alternativa për një lëndë. Një kaos i vërtetë për nxënësit, për mësuesit, për prindërit, për sistemin në tërësi.

Jemi dëshmitarë të denoncimeve të shumta që vinin nga media, që vinin nga mësuesit, që vinin nga prindërit, që vinin edhe nga institucionet ndërkombëtare, por vinin në vesh të shurdhër. Prandaj, me të ardhur në krye të Ministrisë së Arsimit, në krye të punëve të këtij vendi, qeveria shqiptare punoi në dy linja. Linja e parë kishte të bënte me pastrimin e kaosit të teksteve me plot gabime, që denoncoheshin nga mësuesit e nga prindërit. Pyetëm mësuesit, dhe në morinë e 1310 teksteve, ishin mësuesit ata që i refuzuan dhe hoqën nga katalogu plot 600 tituj tekstesh. Mendoni pak: gati 50 % e teksteve që përdorehin nga fëmijët shqiptarë u refuzuan si tekste me gabime të rënda, që deformonin dijen dhe edukimin në shkollat shqiptare.

Paralelisht me këtë, ne punuam me reformën e re të kurrikulës e të teksteve, duke ndryshuar ligjin dhe duke mundësuar kufizimin e alternativave në jo më shumë se tre, duke vendosur një set standardesh shumë të holla, profesionale, në procesin e përzgjedhjes së teksteve të reja. Për lëndët shkencore sollëm tekstet më të mira, duke përkthyer dhe përshtatur ato me të cilat sot punojnë shkollat në Angli dhe në vende të tjera europiane.

Po ashtu vendosëm vitin e provës për çdo tekst që hynte në sistemin shkollor, që mësuesit të deklararin edhe se sa e si u përgjigjeshin interesave të shkollës apo për të konfirmuar nëse tekstet kishin ndonjë gabim.

Në mënyrë të studiuar, ne zbatuam tekstet e reja në sistemin arsimor, duke filluar hap pas hapi në fillim me klasën e parë e me klasën e gjashtë, pastaj me klasën e dytë, të shtatë e të dhjetë, me klasën e tretë, të tetë e të njëmbëdhjetë, ndërsa sivjet do të fillojnë me tekstet e reja klasa e katërt, e nëntë dhe e dymbëdhjetë, për të përfunduar tërë ciklin vitin e ardhshëm shkollor, pra me klasën e pestë. Kjo është edhe arsyeja pse këtë vit, nga klasa e parë e deri në klasën e katërt i japim tekstet falas. Vitin tjetër ne do ta mundësojmë dhënien e teksteve falas edhe për fëmijët e klasës së pestë.

Po ashtu, tekstet e reja kanë një përmbajtje dixhitale, që është një mundësi më shumë për shkollën, për nxënësit, për të përsosur jo vetëm aftësitë e tyre, po edhe për të mundësuar ambiente të ndryshme si cilësi të re të nxënies.

Është e vërtetë që krahas kësaj, ne mundësuar rritjen edhe në tetë kategori të nxënësve që përfitonin tekste falas në vitet e shkuara, duke futur aty fëmijët e policëve të vrarë, familjet që kishin tre apo më shumë fëmijë në shkollë, fëmijët që janë nëpër spitale, të rinjtë që janë në institucionet e paraburgimit, si dhe disa kategori të tjera, siç ishte kategoria e fëmijëve, ku kryefamiljari është person me aftësi të kufizuar.

Sivjet, falë reformave të qeverisë shqiptare, erdhi momenti që ne të mundësojmë tekste falas për 190 mijë fëmijë në sistem. Pra, nga 400 mijë nxënës, që sot punojnë me tekstet e kurrikulës së re, 190 mijë prej tyre përfitojnë tekste falas.

Dua t'ju falënderoj ju, të nderuar kolegë, të gjithë mësuesit e Shqipërisë, që po bëjnë një punë shumë të mirë në shkollë, si qendër e dijes dhe edukimit, duke mundësuar një komunikim të ri dhe një histori të re në shpërndarjen e librave shkollorë.

Unë besoj fort se kjo mundësi që u jepet fëmijëve të familjeve shqiptare lidhet me dy momente të rëndësishme: së pari, lehtëson xhepin e familjeve shqiptare me një produkt tejet cilësor të standardeve europiane; së dyti, ka të bëjë me edukimin në marrëdhënie me librin, marrëdhënien e shkollës me librin, si dhe marrëdhënien e fëmijës me librin.

Me këtë nismë që kemi ndërmarrë unë besoj se do të kemi një situatë të re në sistemin tonë arsimor, duke na dhënë rezultatet e pritshme, të cilat do t'i shikojmë shumë shpejt në

raportin përfundimtar vjetor të PIZA-s dhe në të gjitha matjet periodike që ne i bëjmë sistemit tonë arsimor.

Të nderuar deputetë, edhe një herë faleminderit për gjithçka që po bëni këto ditë për ta përcjellë këtë moment të ri si një moment përgjegjësie dhe vëmendjeje maksimale që ne kemi për nxënësit dhe mësuesit!

Faleminderit!

Vasilika Hysi –Faleminderit, zonja Nikolla!

Fjalën e ka ministri Damian Gjijnuri. Të përgatitet deputeti Arben Pëllumbi.

Damian Gjijnuri – Mirëdita!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë, që na ndiqni nëpërmjet ekraneve,

Në fakt, ky akt normativ dhe ky buxhet konfirmojnë atë që tashmë është bërë e ditur, trajektoren e rritjes dhe konsolidimit ekonomik të Shqipërisë. Pra, ekonomia shqiptare dhe buxheti paralel me të janë duke u konsoliduar dhe njëkohësisht duke adresuar nevojat kryesore për investime. Përtej elementeve të tjera shoqërore apo elementeve të ndihmës, që u vijnë shtresave në nevojë apo çështjeve të tjera, siç mund të jetë arsimi dhe shëndetësia, unë dua të ndalem te një pjesë e rëndësishme, që mbuloj si ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, kryesisht tek infrastruktura. Çfarë bën ky buxhet dhe ky akt normativ?! Konsolidon pikërisht atë trajektore të nisur dhe siguron financimin e nevojshëm për përfundimin e të gjithë programit kombëtar të rrugëve që ne sapo kemi nisur.

Pak më parë dëgjova nga Elbasani ata që janë mbledhur atje si kukudhë për të bërë parlamentin paralel, të cilët po preknin disa plagë për rrugët, që i kanë hapur vetë. Kryetari i opozitës merr guximin dhe flet për rrugën Tiranë-Elbasan, duke na e shitur si dështimin tonë, por harron se ishte një rrugë e filluar pa projekt, e filluar gjoja me 160 milionë euro, e cila përfundoi me mbi 400 milionë euro. Kjo ndodhi sepse s'ka pasur projekt të plotë dhe s'ka qenë menduar ashtu siç duhet, për të mos folur pastaj për keqmenaxhimin e vazhdueshëm që i është bërë asaj rruge dhe që, fatmirësisht, është duke u hetuar nga prokuroria.

Për ata që deklarojnë se kanë bërë rrugë, dua t'u them një fakt qytetarëve të Elbasanit: rrugët ata vetëm i filluan, bënë procedura

tenderësh dhe, kryesisht, u mbaruan nga kjo qeveri në 5 vjetët e fundit dhe do të vazhdojnë në 3 vjetët e ardhshëm. Pse e them këtë?! Mjafton t'u kujtoj qytetarëve se kur mbaroi rruga Rrogozhinë-Plepa. Të gjithë e dinë shumë mirë se ajo rrugë ishte e hapur, e papaguar dhe qe barra e kësaj qeverie për ta përfunduar atë brenda standardeve të pranueshme.

Thonë se ne nuk kemi bërë rrugë të reja. Meqenëse jemi në qarkun e Elbasanit, kur u bë rruga Elbasan-Gramsh, një rrugë totalisht e re?! Meqë këta thonë se nuk janë bërë rrugë 5 vjetët e kaluara, kur u bë rruga Lushnjë-Berat?! Megjithëse ai sektor mund të ishte menaxhuar shumë më mirë, këto rrugë u bë në kohën e qeverisjes sonë. A përfundoi ndonjëherë rruga Durrës-Kukës?! Asnjëherë! Sot ajo rrugë po përfundon. Pra, sot që flasim, në segmentin Kukës - Morinë, që është pjesa më e degraduar e rrugës, është duke u punuar dhe do të përfundojë. Po punohet për urën, është bërë tenderimi për pjesën e mbetur të rrugës, është lidhur kontrata dhe ajo rrugë do të përfundojë.

Kur përfundoi rruga me parametrat e duhur nga Thumana deri në Milot, përfshirë edhe nyjën e Milotit?! Për ata që e filluan shumë e shumë vjet më parë, nyja e Milotit për herë të parë u hap në gusht. Këtu është krijuar një perceptim që po bërë procedurën e tenderit, ka mbaruar rruga, por nuk është ashtu, sepse projekte dhe tenderë mund të bëjnë të gjithë, por problemi është nëse kemi financimet e nevojshme për të përfunduar një vepër, dhe këtë dua ta lidh me buxhetin. Pse ka rëndësi një buxhet i konsoliduar, i qartë dhe jo një buxhet që nuk mbështet projektet e hapura?! Sepse kur krijohen më shumë detyrime sesa mundësi për t'i paguar ato, vendet falimentojnë. Prandaj, buxheti i shtetit dhe detyra e vështirë e Ministrisë së Financave dhe e kësaj qeverie është t'i mbajnë në parametrat e duhur projektet, t'i hapin, t'i financojnë dhe t'i përfundojnë ato në kohën e duhur dhe jo t'i lënë rrugëve.

Çfarë garanton ky buxhet dhe hapësirat buxhetore që ka krijuar kjo qeveri për financimet e ardhshme?! Jo vetëm që do të përfundojnë të gjitha akset e hapura, por edhe ato për të cilat kemi thënë se janë pjesë e programit të rrugëve, do të mbyllen brenda këtij 4-vjeçari. Do të mbyllet brenda këtij mandati Unaza e Tiranës, pjesa lindore dhe pjesa nga Pallati me Shigjeta te sheshi "Shqiponja"; do të mbyllet rruga Kardhiq-

Delvinë, që e filluan dhe e lanë në mes, sepse nuk kishin para, pastaj e harruan fare, nuk iu interesonte më. Për këtë rrugë janë duke u zhvilluar procedurat e tenderit. Në datën 10, nëse nuk gaboj, janë ofertat, lidhet kontrata dhe fillon edhe ky kantier për të mos u ndalur më. Do të përfundojnë të gjitha projektet e partneritetit publik-privat, që në i filluam këtë vit. Është e vërtetë që u desh pak kohë, sepse ne nuk kishim projekte të plota dhe kjo ndodhi pikërisht për të shmangur të gjitha problematikat që janë hasur për ndërtimin e rrugëve shqiptare, sepse, kur nuk ke projekt të plotë, kur s'ke gjeologjinë e saktë, kur ke probleme me menaxhimin e kontratës, patjetër që kontrata do të mbetet rrugëve dhe do të kërkojë më shumë para sesa duhet.

Me partneritetin publik-privat, të katra projektet madhore do të përfundojnë, një pjesë e të cilave ka filluar, siç është Rruga e Arbrit, e cila po progreson, megjithëse skeptikët thoshin se ku do t'i gjejnë paratë privatët për ta bërë. Kjo tregoi se institucionet financiare paskan besim te ky instrument i qeverisë shqiptare dhe nuk qenka thjesht një premtim i hedhur në ajër. E njëjta gjë do të ndodhë edhe me rrugën Thumanë-Kashar, me rrugën Milot-Balldren dhe me Orikumin. Pra, do të përfundojmë akse të rëndësishme, që ndikojnë në ekonominë shqiptare, kryesisht në turizëm. Të gjitha investimet në infrastrukturë janë në funksion të rritjes ekonomike, nuk janë investime në tym dhe as për qëllime të thjeshta elektorale, siç ka ndodhur herë të tjera, që janë hedhur miliona euro në rrugë, që, po të kalosh tani, i ka marrë lumi ose natyra. Jo, këto janë rrugë që ndikojnë direkt në rritjen ekonomike dhe në zhvillimin e turizmit.

Për sa u përket bajpaseve të Fierit dhe të Vlorës, sepse edhe këtë mundohen t'ia faturojnë kësaj qeverie, fatkeqësisht, është mënyra se si këto rrugë u kontraktuan në vitin 2013, të cilat ngelën rrugëve. E thashë edhe një herë dhe dua ta përsëris për ata që na dëgjojnë, për qytetarët shqiptarë, nuk ka rëndësi kur e bën një kontratë, por çfarë kontrate bën dhe sa e mbulon këtë kontratë. Edhe në jetën e përditshme, nëse të vjen një njeri dhe të bën një premtim, ti nuk e beson. Kështu ndodh edhe me projektet e mëdha kombëtare.

Pasi u zgjidhën kontratat e dështuara me kompani të dështuara, për të mos thënë me lojëra me nënkontraktorë, që i dinë të gjithë qytetarët

shqiptarë, sot që flasim, ato procedura kanë vajtur për miratim në BERZH. Pra, procedurat e tenderit janë transparente, janë përzgjedhur fituesit dhe pritët vetëm përgjigjia e BERZH-it. Jam i bindur se brenda një muaji edhe këto dy kantiere do të fillojnë punën dhe vitin tjetër bajpasi i Fierit do të jetë funksional. E njëjta gjë do të ndodhë edhe me rrugën e Elbasanit, ku shumë shpejt do të vijë në parlament shtesa e marrëveshjes së financimit për të përfunduar këtë segment rrugor dhe besoj se brenda shtatorit do ta kemi të miratuar në Kuvend, do të kemi fondet në dispozicion dhe ky kantiere do të fillojë punën. Brenda vitit do të bëhet e mundur lidhja me tunelin dhe besoj se brenda pak muajsh rruga do të dorëzohet e plotë me të gjithë parametrat e nevojshëm. Disa ditë më parë ka përfunduar procedura për zgjidhjen e rrëshqitjes në pjesën e Elbasanit, që, po ashtu, janë defekte të trashëguara të projektit, (fatkeqësisht faturën e mbajmë ne), pra edhe ajo rrugë do të marrë drejtim dhe ky aks i rëndësishëm kombëtar do të hapet përfundimisht. Për të mos folur pastaj për rrugët që tashmë janë përfunduar, siç është një nga rrugët më të bukura të Shqipërisë, rruga Lin-Pogradec, një projekt tërësisht i përmirësuar nga kjo qeveri, një rrugë e mrekullueshme, që vërtet i ka hije një qyteti si Pogradeci me potenciale të mëdha turistike.

Investimet në infrastrukturë do të vazhdojnë edhe me rrugë të tjera. Ne jemi duke përgatitur projektet e plota edhe për rrugë të tjera, siç është përfundimi i unazës së plotë të Tiranës, por edhe ndërhyrjet në disa akse të rëndësishme kombëtare, të cilat do të kompletojnë rrjetin e plotë kombëtar shqiptar, me qëllim komunikimin e një lëvizshmërie të pranueshme shumë të mirë brenda standardeve europiane dhe mbi të gjitha interkonektivitetin me rajonin.

Është e thjeshtë të thuash: “Dua rrugë këtu”, por kjo nuk mjafton dhe unë u them qytetarëve shqiptarë se buxheti i qeverisë shqiptare nuk mjafton të mbyllë çdo rrugë që ka ky vend. Ky është një vend malor, është një vend që nuk ka pasur infrastrukturë, është një vend që kërkon miliarda dollarë dhe paratë po i hedhim aty ku duhet. Pse?! Sepse po bëjmë rrjetet kryesore kombëtare, që të gjenerojmë ekonominë, në mënyrë që nesër buxheti i shtetit të krijojë të ardhura dhe të financojë edhe pjesët

e tjera të rrugëve. Edhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit po investon një paketë të rëndësishme në infrastrukturën rrugore, ku shumë shpejt do të përfundojnë edhe procedurat e pjesës së mbetur të rrugës së Lumit të Vlorës, por edhe shumë destinacione të tjera, që do t'i vlejë turizmit shqiptar.

Qytetarët shqiptarë në këto vite, e tha ministri i Financave, po e them edhe unë, do të kenë paketën më të madhe të investimeve rrugore. Në tre vjetët e ardhshëm janë parashikuar 1,4 miliardë dollarë, që do të kompletojnë rrjetin rrugor shqiptar, por mbi të gjitha do të ndikojnë direkt në rritjen ekonomike të këtij vendi.

Faleminderit dhe suksese qeverisë në këtë buxhet!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Gjyknuri!

Fjalën e ka deputeti Arben Pëllumbi. Të përgatitet ministria Ogerta Manastirliu.

Arben Pëllumbi – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë, ju që keni besimin dhe vazhdoni të na ndiqni, pavarësisht ngjarjeve të pakëndshme, retorikave dhe “betejave” opozitare boshe, shpeshherë edhe vulgare në këtë sallë, ju që jeni të bindur se maxhoranca parlamentare dhe qeverisëse, por edhe për më skeptikët, ne e kemi shumë mirë parasysh arsyen pse jemi këtu: të kemi vëmendje dhe përkushtim ndaj jush, por jo vetëm kaq. Motoja jonë gjen më së miri mishërimin në thënien e filozofit të madh gjerman Maks Veber: “Puna e politikanit është e ardhmja dhe përgjegjësia përballë kësaj”. Po, të nderuar qytetarë, e ardhmja dhe përgjegjësia që kemi përballë saj, sepse me këtë jemi matur dhe me këtë do të vazhdojmë të matemi.

Ne vijmë sot me një akt normativ, një procedurë normale për të bërë korrigjime në buxhetin e shtetit, për të përmirësuar akoma më shumë performancën qeverisëse, për të shfrytëzuar më mirë paratë publike, por edhe për të rritur vëmendjen ndaj jush, sidomos ndaj shtresave më vulnerabël: pensionistëve dhe familjeve në nevojë.

Do të ndalem në pikat më të rëndësishme të këtij akti. Foli ministri, folën kolegët, do të flasim edhe kolegët e tjerë, por fillimisht dua të ndaj me ju qëllimin e pyetjes sime drejtuar ministrit të

Financave dhe Ekonomisë në komision gjatë shqyrtimit të këtij akti normativ, në kushtet kur opozita vendosi një marrëdhënie të kushtëzuar me parlamentin, bojkotoi seancën e hapjes së këtij sesiioni dhe gjithashtu nuk ishte prezent në komision ku edhe diskutohen me detaje dhe në mënyrë profesionale këto ndryshime të buxhetit. Unë kam mundësi të shpreh pikëpamjet e mia, të bëj vërejtje dhe të paraqes alternativa të tjera. Ky është një normalitet politik që të bën të fitosh elektorat dhe të përgatitësh alternativën tënde për zgjedhjet e ardhshme. Siç e dimë, ata nuk zgjedhën normalen dhe nuk është hera e parë që e bëjnë këtë gjë. Zgjedhën të shkonin në Shkodër, ku sigurisht kanë ndodhur disa ngjarje të rënda e të dënueshme, për të cilat, siç na informoi ministri i Brendshëm në seancën e kaluar, po punohet intensivisht. Një pjesë e tyre janë zbardhur dhe një pjesë tjetër priten të zbardhen shpejt. Prandaj të gjithë ne duhet të nxitim dhe ta përkrahim fort punën e Policisë së Shtetit në shërbim të rendit dhe sigurisë publike. Sot kanë shkuar në Elbasan. Punë të mbarë!

Le t'i kthehemi pyetjes sime, e cila, pak a shumë, konsistonte në një opinion të mbështetur në shifrat e ministrit të Financave për performancën e ekonomisë sonë gjatë muajve të verës, në veçanti të turizmit, i cili është shumë i ndjeshëm ndaj rendit dhe sigurisë publike, aq më tepër kur bëhet fjalë për turistë të huaj, ndoshta edhe skeptikë ndaj nesh. Sa prenotime u anuluan? Sa turistë të huaj nuk pranuan të vinin në Shqipëri, pasi këtu jeta u bë e pasigurt, sipas opozitës sonë "largpamëse"? Përgjigjja nuk mund të ishte e ndryshme nga ajo që dimë të gjithë. Ne këtu e kemi prekur, por edhe shumica e njerëzve, sidomos bizneset dhe kryesisht ata që operojnë në fushën e turizmit dhe tregtisë, rritjen ekonomike, rritjen e numrit të turistëve sidomos atyre të huaj, kryesisht perëndimorë me kërkesa të larta. Rreth 4,4 milionë sipas disa statistikave zyrtare. Operatorë turistikë të niveleve botërore vazhdojnë të japin oferta në drejtim të stabilimenteve tona turistike. Ka pasur një fluks të shtuar fluturimesh, tragetesh dhe mjetesh në të gjitha pikat e kalimit kufitar. Nuk ka pasur as edhe një ngjarje të rëndë, ku të jetë përfshirë qoftë edhe një turist i huaj apo vendas. Nuk kanë ndodhur ngjarje të tilla në bregdetin e Durrësit, ku ka një numër të madh lëvizjesh, as në Vlorë, në Rivierë, në Sarandë, në Velipojë apo në

Shëngjin, por as edhe në zonat turistike malore, të cilat po njohin një numër të madh lëvizjesh.

Tashmë e kemi të gjithë të qartë qëllimin e opozitës, pra furtunën e radhës në gotë! Gjithsesi, ne jemi mbledhur sot për të diskutuar dhe për të votuar aktin normativ, i përcjellë nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për rishikimin e buxhetit të shtetit. Ky rishikim vjen si nevojë e emergjencë dhe synon të rritë sigurinë në realizmin e treguesve të buxhetit nëpërmjet rritjes së eficiencës së përdorimit të burimeve publike në rialokime drejt projekteve të investimeve me progres të lartë deri tani. Dua të theksoj edhe një herë, sepse e kam shumë për zemër, sigurimin e një shpërblimi për pensionistët dhe familjarët në nevojë në fund të vitit. Vëmendja ndaj qytetarëve është motivi ynë.

Ju faleminderit!

Vasilika Hysi – Ju faleminderit, zoti Pëllumbi!

Fjalën e ka ministria Ogerta Manastirliu.

Të përgatitet deputetja Evis Kushi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, fjalën e ka deputetja Evis Kushi.

Evis Kushi – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Së pari, shpreh keqardhjen që opozita nuk është e pranishme sot në këtë seancë, ku po shqyrtojmë rishikimin e buxhetit të vitit 2018. Nuk ishte as kur e diskutuam atë në Komisionin për Ekonominë dhe Financat dhe nuk është as sot. Në fakt, çdo çështje që lidhet me buxhetin e shtetit duhet të ketë rëndësi parësore jo vetëm për deputetët e Komisionit të Ekonomisë, por për të gjithë deputetët e këtij Kuvendi, të cilët kanë detyrimin të japin kontribut për vendime sa më të mira dhe sa më të drejta. Megjithatë, kjo nuk duhet të na pengojë ne, deputetëve të maxhorancës, ta bëjmë siç duhet punën tonë me angazhimin dhe me përgjegjësinë maksimale ndaj qytetarëve, që na kanë dhënë mandatin për të qeverisur vendin dhe për të ndërmarrë reforma për zhvillimin e vendit dhe që përmirësojnë ndjeshëm jetën e tyre.

Pa hyrë në detaje, akti normativ që po diskutojmë sot është një instrument ligjor në përputhje të plotë me kërkesat e parashikuara në Kushtetutë dhe nuk aplikohet për herë të parë, përkundrazi, është aplikuar çdo vit, edhe gjatë

mandatit të parë të qeverisë socialiste. Qëllimi i tij është pikërisht reflektimi i të gjitha ndryshimeve që kanë ndodhur në ekonomi gjatë gjashtëmujorit të parë, si dhe i pritshmërive të treguesve makroekonomikë gjatë periudhës në vazhdim.

Cilat janë këto ndryshime që kanë ndodhur në ekonomi dhe që e bëjnë të domosdoshëm këtë rishikim të buxhetit?

Së pari, një lajm shumë i mirë për ekonominë e vendit është përmirësimi i ritmeve të zhvillimit, duke arritur që prodhimi i brendshëm bruto të rritet në 4,45% në tremujorin e parë të vitit 2018, nga 3,84% që ishte në vitin 2017, duke vijuar kështu trendin e përsheptimit të ritmit të rritjes që prej vitit 2014.

Së dyti, një tregues tjetër makroekonomik, për të cilin ka një ndjeshmëri të lartë publike, është punësimi. Performanca e mirë e ekonomisë reale gjatë vitit 2017 dhe tremujorit të parë të vitit 2018 u reflektua në mënyrë të qartë edhe në tregun e punës. Në fund të vitit 2017 shkalla e papunësisë ra në nivelin 13,6%. Ndërkohë, vijoi të bjerë edhe në tremujorin e parë të këtij vitit në 12,5%, duke regjistruar kështu nivelin më të ulët të papunësisë që nga tremujori i parë i vitit 2012.

Së treti, një aspekt tjetër i rëndësishëm, ku dua të ndalëm gjatë këtij diskutimi, lidhet me nivelin e të ardhurave të përgjithshme në buxhet, të cilat, krahasuar me planin e gjashtëmujorit të parë të vitit 2018, janë realizuar në nivelin 98%. Konkretisht, në gjashtëmujorin janar-qershor 2018 janë arkëtuar gjithsej në buxhet 217 miliardë lekë, rreth 5 miliardë lekë më shumë, ose 2,22% mbi nivelin e gjashtëmujorit të vitit paraardhës, pra të vitit 2017, ndërsa të ardhurat tatimore të periudhës janë 202,3 miliardë, pra 6,1 miliardë lekë më shumë se në gjashtëmujorin e vitit 2017, ose ndryshe me një rritje prej 3,1%. Sigurisht që këtu ndikojnë shumë faktorë, por një ndër më të rëndësishmit është puna e administratës tatimore dhe doganore, lufta kundër informalitetit dhe punës së padeklaruar, e kombinuar kjo me një fushë të gjerë edukimi, kontrolli dhe verifikimi, e cila ka dhënë ndikim mjaft pozitiv në vetëdeklarimin e punëmarrësve dhe sigurimin e të punësuarve.

Pa dyshim, me këtë nuk themi që kemi administratën më të mirë në historinë e ekonomisë shqiptare, as nuk pretendojmë se kemi arritur maksimumin, përkundrazi jemi

shumë ambiciozë dhe shumë kritikë në këtë aspekt. Nuk diskutohet që ka ende probleme; ka ende raste korrupsioni, informaliteti apo evazioni fiskal, po e rëndësishme është tendenca pozitive në rritje. Rëndësi ka fryma pozitive dhe përkushtimi i qeverisë me masa konkrete për të ndryshuar situatën, për të ndryshuar sistemin, por, mbi të gjitha, për të ndryshuar mentalitetin që është rrënjësuar thellë te njerëzit. Prandaj inkurajoj fort administratën tatimore dhe doganore që të vazhdojë me këtë frymë, të mos ndalet dhe t'i realizojë sa më mirë objektivat e vendosur në drejtim të konsolidimit fiskal.

Dua të them dy fjalë shumë shkurt edhe për turizmin, i cili është një sektor që këtë vit ka shënuar një rritje të konsiderueshme në raport me vitet paraardhëse. Siguria, pastërtia, cilësia e shërbimit, por, mbi të gjitha, promovimi që i është bërë këtë vit kanë qenë shumë të mëdha, duke sjellë rritje të numrit të turistëve. Impakti në ekonomi ka qenë shumë i rëndësishëm. Ka pasur hapje biznesesh të reja dhe rritje të punësimit. Në disa zona turistike shifrat kanë qenë shumë optimiste. Ka pasur 22% më shumë punësime në Sarandë, 7% më shumë në Vlorë apo në Lezhë etj. Për sa u takon të ardhurave, duke marrë në konsideratë rritjen e numrit të turistëve afërsisht 20%, këtë vit parashikohen rreth 2 miliardë euro, ose afërsisht 500 milionë euro të ardhura të arkëtuara në ekonomi nga turizmi më shumë se vitin e kaluar.

Po kthehem te ndryshimet që parashikohen me aktin normativ që po diskutojmë sot, të cilat konsistojnë në rialokimin e disa zërave të shpenzimeve që synojnë përdorimin më eficient të fondeve publike, si dhe krijojnë mundësi për disa shpenzime të domosdoshme dhe emergjente. Konkretisht, bëhet fjalë për ndryshime, të cilat bëjnë të mundur përmbushjen e tre objektivave të rëndësishëm.

Së pari, garantimin e shpërblimit të pensionistëve dhe shtresave në nevojë.

Së dyti, rritjen e eficiencës së përdorimit të burimeve publike nëpërmjet rialokimeve të disa zërave të shpenzimeve.

Së treti, rritjen e sigurisë në realizimin e treguesve të buxhetit.

Unë do të ndalem shumë shkurt vetëm te pika e parë, pra te garantimi i shpërblimit të pensionistëve dhe shtresave në nevojë. Këtu ne dallojmë qartazi nga paraardhësit tanë, sepse nuk

e lidhim pagesën e solidaritetit me vitin elektoral, përkundrazi e kemi kthyer këtë paketë në një standard dhe e kemi përfshirë në buxhet të konsoliduar me një shifër konkrete, për të garantuar detyrimin e qeverisë ndaj pensionistëve dhe shtresave në nevojë.

Ne si maxhorancë jemi plotësisht të angazhuar të vazhdojmë punën për rimëkëmbjen e ekonomisë shqiptare, ndaj vëmendja dhe energjitë tona do të vazhdojnë të jenë të fokusuar te njerëzit e thjeshtë dhe shtresat në nevojë.

Ju faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Kushi!

Fjalën e ka ministrja Ogerta Manastirliu.

Të përgatitet deputetja Antoneta Dhima.

Ogerta Manastirliu – Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Rishikimi i buxhetit të vitit 2018 nëpërmjet këtij akti normativ në thelb vijon të mbështesë nxitjen e reformave të nisura nga qeveria shqiptare, me synim ripërmirësimin e eficiencës së përdorimit të fondeve publike, duke nxitur investimet në sektorët prioritarë të ekonomisë dhe duke sjellë pa dyshim një impakt të drejtpërdrejtë te shërbimet e ofruara për qytetarët.

Akti normativ konfirmon edhe një herë përparësinë që u ka dhënë qeveria shqiptare politikave sociale dhe programeve të mbështetjes për shtresat në nevojë, pasi me këtë buxhet të rishikuar ne garantojmë paketën e solidaritetit për pensionistët, për personat me aftësi të kufizuara, për familjet përfituese të programit të ndihmës ekonomike dhe për grupe të tjera në nevojë. Me buxhetin e vitit 2018 ne vijojmë të sigurojmë përfundimin e financimit dhe zbatimit të të gjitha investimeve infrastrukturore të nisura gjatë vitit 2017, me qëllim që të garantojmë një shërbim cilësor dhe me vëmendje të drejtpërdrejtë te qytetarët. Jemi të vetëdijshëm se mbulimi universal bëhet më i prekshëm për qytetarët nëse shoqërohet me akses në shërbime, gjithashtu, edhe me cilësi. Ndaj, jemi duke investuar në programin e infrastrukturës së institucioneve shëndetësore, në aparatura biomjekësore dhe në burime njerëzore, me qëllim që kujdesi shëndetësor bashkëkohor të ofrohet sa më pranë vendbanimit të qytetarëve.

Unë do të doja të ndalesha në disa nga programet prioritare të qeverisë në lidhje me sektorin e shëndetësisë dhe të mbrojtjes sociale. Kur flasim për shëndetësinë, sigurisht një ndër elementet kryesore është programi i parandalimit, kontrolli mjekësor bazë për moshën 35-70 vjeç. Deri në fund të muajit gusht janë 287 mijë e 584 qytetarë që e kanë kryer këtë kontroll mjekësor falas, pa pagesë. Kjo gjë tregon një interes të shtuar të qytetarëve për kontrollin mjekësor bazë, edhe pas të gjithë baltës, pas të gjithë negativitetit që opozita vijon të shfryjë ndaj një programi kaq shumë të rëndësishëm për jetën e qytetarëve, një program parandalimi, i cili vendoset pranë mjekut të familjes, si një element i shtuar, për të vlerësuar riskun që qytetarët kanë ndaj sëmundjeve jo të transmetueshme dhe atyre kronike. Por qytetarët e kanë kuptuar vlefshmërinë e këtij programi direkt në funksion të mbrojtjes së shëndetit të tyre. Prandaj, unë do të doja t'ju thosha që, pavarësisht se në dy vjetët e parë kemi hasur vështirësi pikërisht nga balta që iu hodh këtij programi, sot qytetarët janë më të ndërgjegjësuar për të mirat që u sjell kontrolli vjetor falas, të cilin qeveria e ka vënë në zbatim në 380 kabinete, në të gjitha qendrat shëndetësore të vendit, pikërisht për të garantuar shëndet më të mirë për qytetarët dhe për të shmangur ato sëmundje kronike, që më pas afektojnë edhe financiarisht buxhetin e shtetit. Një qytetar që nuk i parandalon sëmundjet në kohë, është i destinuar të shkojë t'i kurojë ato dhe të invalidizohet. Ndaj, vetëm nga rezultatet trevjeçare të implementimit të këtij programi, dua të ndaj disa të dhëna me ju shkurtimisht: 19% e qytetarëve kanë rezultuar me risk të lartë për sa u përket sëmundjeve kronike; 34% e tyre janë me risk të moderuar, ndërsa 47% e tyre me risk të ulët. Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë se 20% e atyre që kanë kryer kontrollin mjekësor bazë janë referuar te mjeku specialist për të parandaluar sëmundjet, që më pas mund të sillnin edhe invalidizimin e tyre, kështu ata do të shkonin drejt një sëmundjeje, e cila më pas jo vetëm do të sillte përkeqësimin e shëndetit të tyre, por edhe për shtetin do të sillte pa dyshim një impakt financiar shumë më të lartë, pasi do të ishin përfshirë shumë më herët në skemën e rimbursimit dhe do të shkonin më shumë drejt spitaleve për të kryer trajtime shumë më të

shtrenjta. Por ajo çfarë ne kemi në vëmendje është kujdesi ndaj shëndetit të qytetarëve. Ky është një program i përkujdesjes, një program parandalimi, për të cilin ne do të bëjmë maksimumin që të gjithë qytetarët e moshës 35-70 vjeç ta përfitojnë falas çdo vit këtë program, i cili, nga njëra anë, parandalon dhe, nga ana tjetër, na vendos në një sistem të ri të administrimit të të gjitha të dhënave që ofron ky program, me qëllim bërjen e eficiente të politikave në kuadër të shëndetit të popullatës.

Një program shumë i rëndësishëm, që u përmend edhe nga ministri i Financave, i cili është i orientuar drejt mbështetjes së të gjitha atyre kategorive që vuajnë nga sëmundjet kronike e akute dhe që trajtohen nëpërmjet një skeme shumë të rëndësishme që ofron sot qeveria, është skema e rimbursimit të barnave për sëmundjet kronike dhe ato akute. 20 milionë euro më shumë është fondi për rimbursimin e barnave dhe nuk paguhet më. Nuk ka më bashkëpagesë nëse ti je ose jo i siguruar, por të gjithë qytetarëve që kanë nevojë të trajtohen nëpërmjet listës së barnave të rimbursueshme, ky rimbursim u ofrohet falas për të gjitha alternativat e para.

Kemi shtuar alternativat, kemi shtuar numrin e përfituesve dhe pa dyshim u kemi dhënë mundësi të gjithë atyre qytetarëve, të cilët, edhe pse nuk janë të siguruar, të mos kenë asnjë bashkëpagesë në përfitimin e rimbursimit të listës së barnave, pra të rimbursueshme.

Në sektorin e shëndetësisë jemi duke realizuar këtë vit investime bazë në infrastrukturë, në pajisjet biomjekësore dhe, pa dyshim, në atë çfarë ne e quajmë aset kryesor, në burimet njerëzore.

Jemi duke realizuar për vitin 2018 më shumë se 14 milionë euro investime, duke dyfishuar kështu investimet vjetore për sektorin e shëndetësisë. Këtë vit përfundojnë 80 qendra shëndetësore në të gjithë vendin dhe tek ambulancat. Çfarë është ky program? Është programi i rehabilitimit të 300 qendrave shëndetësore në katër vjet. Për herë të parë kjo qeveri i kushton vëmendje kujdesit parësor në komunitet dhe kur flasim për mbulim universal, e fillojmë me aksesin që qytetarët duhet të kenë në shërbimin shëndetësor.

300 qendrat shëndetësore, që do të ndërtohen dhe do të rehabilitohen gjatë katër

vjetëve, pa dyshim do të kenë impakt direkt në jetën e qytetarëve, në përmirësimin e kushteve të cilësisë së shërbimit që ata marrin në portën e parë të shërbimit që u ofrohet shërbimi parësor.

80 qendrat shëndetësore, për të cilat tashmë ka filluar kantieri nga Veriu në Jug, do të jenë gati në fund të këtij viti për të ofruar kushte shumë të përmirësuara, me standarde bashkëkohore dhe kujdes shëndetësor për qytetarët. Pikërisht këto qendra shëndetësore të rehabilituara, këto ambulanca në pika tejet delikate të vendit, ku infrastruktura linte shumë për të dëshiruar, do të jenë porta e parë e shërbimit, ku qytetarët të mund të diagnostikohen në kohë edhe nëpërmjet programit të kontrollit mjekësor bazë, që tashmë është shtrirë në të 380 kabinetet e qendrave shëndetësore në të gjithë vendin. Por jo vetëm kaq. Ne jemi duke investuar, gjithashtu, edhe në miradministrimin e sistemit, në procese dhe në elemente, të cilat rrisin transparencën, rrisin llogaridhënien. Vetëm nëpërmjet sistemit të e-referimit, i cili tashmë po shtrihet në të gjithë Shqipërinë (në qendrat shëndetësore dhe në poliklinikat e specialiteteve), ne jemi duke garantuar që qytetarët të marrin shërbim në kohë dhe të mos kenë vonesa në marrjen e shërbimeve, vonesa të cilat mund të çojnë në elemente të tjera të abuzivizmit, korrupsionit.

Duke e pasur vëmendjen drejtpërdrejt të qytetarët dhe të hallet e problemet e tyre, jemi duke investuar në të gjithë rrjetin e spitaleve, qoftë në investime thelbësore të infrastrukturës apo qoftë edhe nëpërmjet programit të këtij viti, 4,5 milionë euro për pajisjet biomjekësore në spitalet rajonale, në mënyrë që fokusi dhe objektivi që ne i kemi dhënë...

(Bie gongu)

...vendosjes së standardi të ri për shërbim afër vendbanimit të bëhet realitet brenda këtij mandati.

Gjithashtu, do të doja të ndalesha në investimin më strategjik për sa i përket përmirësimit të infrastrukturës spitalore. QSUT-ja po vijon investimet strategjike për një spital të ri ekselence, i cili tashmë ka filluar të ndërtohet, për sëmundjet e brendshme, që do t'i trajtojë 100% me standarde bashkëkohore të gjithë pacientët, të cilët sot nuk e marrin shërbimin në kushte aq të mira dhe me aq standarde të larta sa pretendojmë. Në përfundim të këtij mandati do të

kemi një spital të ri për sëmundjet e brendshme në QSUT dhe brenda vitit 2019, do të kemi edhe spitalin e ri kirurgjikal.

9 milionë euro janë investuar deri tani në spitalet tona rajonale për një program me partneritet publik-privat për instrumente të reja kirurgjikale dhe për shërbimin e sterilizimit.

Pa dyshim, opozita nuk e ka në fokus shërbimin ndaj qytetarit dhe nuk ka si ta kuptojë përfitimin që qytetarët dhe profesionistët kanë nga të gjitha këto investime që ne po realizojmë në këto prioritete strategjike që kemi pasur për sa i përket përfshirjes së programeve të reja, siç është programi i sterilizimit dhe ai i për instrumente të reja kirurgjikale, që ta sjellim besimin brenda spitaleve tona, brenda spitaleve universitare, rajonale dhe bashkiake.

Vetëm 9 milionë euro janë investuar në spitalet tona për këtë program deri më sot. Ndërkohë, pritët të shtrihet ky investim edhe në ato spitale, ku ne pretendojmë që ndërhyrjet operatore të ofrohen sipas standardeve më të larta bashkëkohore, duke siguruar më shumë cilësi në shërbimin e kirurgjisë dhe ajo çfarë është më e rëndësishme, duke ofruar siguri për jetën e pacientëve.

Për sa i përket një sektori shumë sensitiv, atij të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale, ka një program, i cili tashmë është shtrirë në të gjithë vendin, që është programi i skemës së ndihmës ekonomike. Nuk ka pasur pak debate kjo skemë e re, e cila u implementua në janar të këtij viti, por ajo çfarë na tregoi ishte një mësim i mirë për të gjithë, i cili na dha pamjen e qartë të gjithë asaj fuqie punëtore, të njerëzve, të cilët duke qenë të mësuar me ndihmën ekonomike, nuk përballëshin me tregun e punës dhe me aftësimin profesional. Ky program na nxiti për të vlerësuar edhe më shumë programet e punësimit dhe ato të aftësimit profesional. Nga shtrirja e këtij sistemi dhe deri sot janë më shumë se 1000 individë, të cilët deri dje ishin pjesë e skemës së ndihmës ekonomike, kurse sot janë përfshirë në programet e punësimit dhe janë punësuar duke u bërë pjesë e trajnimeve profesionale, sepse kjo është alternativa jonë. Alternativa e punësimit, e aftësimit profesional, nuk është alternativë e programit të ndihmës ekonomike, e cila padyshim me ndërhyrjen që është bërë, me reformën që është ndërmarrë për të rritur ndihmën ekonomike, për të garantuar që

qytetarët të mos kenë më burokraci në aplikimin për këtë ndihmë e gjithashtu, me transparencën që është ofruar me këtë sistem në raport me të gjithë verifikimet që bëhen për aplikuesit, duhet të evidentojë qytetarët vërtet në nevojë për ndihmë ekonomike, të cilët e kanë ndihmën ekonomike për një periudhë të përcaktuar të jetës, kur gjenden në vështirësi, por që më pas me ndihmën e strukturave tona të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe të shërbimeve sociale, të jenë pjesë e programeve të riintegrit, sepse riintegrimi vlen më shumë sesa programet e suportit për një periudhë të shkurtër për një familje në nevojë që duhet ndihmuar. Padyshim, ky është vizioni ynë: alternimi i programeve të ndihmës ekonomike me programet e aftësimit dhe ato të trajnimit profesional.

Gjithashtu, dua të përmend një program tjetër të rëndësishëm, i cili tashmë po jetësohet brenda sistemit tonë të mbrojtjes sociale, programin e pagesave të paaftësisë, i cili këtë vit ka filluar të reformohet dhe po pilotohet në 2 njësi bashkiake të Tiranës. Ne pretendojmë ta shtrijmë në qytetin e Tiranës dhe patjetër, në të gjithë Shqipërinë. Po punojmë me shumë skrupolozitet në mënyrë që ky program të mos afektojë asnjë person që është vërtet i paaftë dhe ka nevojë për skemën e mbështetjes financiare nga shteti për aftësinë e kufizuar.

Gjithashtu, jemi të orientuar t'u japim të gjithë personave me aftësi të kufizuar mbështetjen që ata meritojnë, që të mund të kemi një vlerësim jo vetëm mjekësor, por një vlerësim biopsikosocial për të gjitha ato familje, të cilat kanë një person me aftësi ndryshe, i cili duhet ndihmuar nga shteti, duke i dhënë edhe shërbimet komplementare, të cilat janë shërbime sociale dhe psikosociale.

Unë do të thosha se sfida të mëdha na presin. Ky akt normativ vendos patjetër në fokus pikërisht këto reforma, nxit reformat e nisura dhe na ngarkon akoma më shumë me përgjegjësi për të pasur vëmendje akoma më të shtuar te qytetarët.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Manastirliu!

Fjalën e ka deputetja Antoneta Dhima!

Përgatitet deputeti Ulsi Manja!

Antoneta Dhima - E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputete,

Të dashur qytetarë shqiptarë,

Komisioni për Ekonominë dhe Financat shqyrtoi dhe miratoi aktin normativ “Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018””.

Shpreh keqardhje të thellë që opozita shqiptare nuk ishte prezent në komision dhe nuk është prezent as sot në këtë seancë për të diskutuar për aktin normativ “Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018””.

Do të dëshiroja të jepnim një shembull bashkëpunimi në menaxhimin e parave të shqiptarëve për shqiptarët, do të dëshiroja shumë që në qendër të debateve tona të jetë të bërit më mirë të gjithçkaje që kërkohet për të përmirësuar jetesën e bashkëqytetarëve tanë, që na kanë besuar dhe na kanë votuar. Ndaj, edhe unë mbetem besimplotë se kjo mund të bëhet, mjafton vetëm vullneti dhe dëshira e palëve.

Ky akt normativ është propozuar nga ana e qeverisë në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në kushtet kur plotëson nevojën dhe urgjencën për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit; përkohshmërinë e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit; fuqinë ligjore të këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre, si dhe miratimin nga Kuvendi të aktit normativ me fuqinë e ligjit.

Akti normativ që jemi duke diskutuar sot do të bëjë të mundur sigurimin e një shpërblimi për pensionistët dhe familjet në nevojë në fund të vitit në vlerën 3,3 miliardë lekë, nga të cilat 3 miliardë lekë në favor të bonusit të pensioneve ose 5000 lekë të rinj për çdo pensionist dhe 300 milionë lekë për kategoritë dhe shtresat në nevojë.

Ajo që duhet të theksohet është fakti se paketa e solidaritetit është shprehja më e drejtpërdrejtë e vëmendjes së kësaj qeverie ndaj qytetarëve. Në pesë vjetët e fundit fondi për mbështetjen e pensionistëve ka shkuar në 11,3 miliardë lekë ose 10% më shumë nga sa u dhanë në tetë vjet të periudhës 2005-2013, ku janë akorduar vetëm 10,5 miliardë lekë. Ky akt normativ do të sjellë rritjen e efikasitetit së përdorimit të burimeve publike për rialokimet

drejt projekteve të investimeve me progres të mirë deri tani, si dhe do të sjellë rritjen e sigurisë në realizimin e treguesve të buxhetit.

Ndryshimet e propozuara në këtë akt normativ nuk do të prekin treguesit kryesorë makroekonomikë dhe ata fiskalë, duke e ruajtur deficitin në nivele të pandryshueshme, si dhe duke forcuar më tej objektivin që ka qeveria për qëndrueshmëri fiskale.

Në pjesën e parë të vitit 2018 ekonomia shqiptare tregoi serish ritme pozitive dhe përsheptueshmëri të rritjes ekonomike.

Në tremujorin e parë të vitit 2018 prodhimi i brendshëm bruto real u rrit me 4,45%, nga 3,84%, që ishte përgjatë vitit 2017. Kjo rritje ekonomike gjatë kësaj periudhe është gjeneruar nga kërkesa e brendshme si konsumi, ashtu edhe investimet. Po kështu, ekonomia ka njohur një përmirësim të dukshëm, çka dëshmohet nga treguesi i ndjesisë ekonomike. Ky tregues qëndron mbi mesataren afatgjatë që prej tremujorit të dytë të vitit 2016 dhe vijon të qëndrojë mbi këtë mesatare edhe për gjysmën e parë të vitit 2018.

Në gjashtëmujorin janar-qershor 2018 janë arkëtuar gjithsej në buxhet 217 miliardë lekë, rreth 5 miliardë lekë më shumë se gjashtëmujori i vitit 2017. Krahasuar me planin e gjashtëmujorit të parë 2018, niveli i realizimit të të ardhurave është 98%. Në këtë gjashtëmujor mbi të ardhurat tatimore të buxhetit kanë ndikuar pozitivisht dhe negativisht një sërë faktorësh. Rritja ekonomike prej 4,45% ka ndikuar pozitivisht në konsolidimin e të hyrave të buxhetit nga sistemi tatimor. Lufta kundër informalitetit dhe punës së padeklaruar, e kombinuar kjo me një fushatë të gjerë edukimi, kontrolli dhe verifikimi, ka dhënë ndikim mjaft pozitiv në vetëdeklarimin e punëmarrësve dhe sigurimin e të punësuarve. Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë rritur me mbi 8,8%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke tejkaluar në këtë mënyrë edhe efektet e rritjes ekonomike. Negativisht në të ardhurat tatimore të gjashtëmujorit të parë ka ndikuar ndryshimi i kursit të këmbimit të monedhave të huaja euro dhe dollarë kundrejt lekut.

Ndërkohë, nisur nga situata energjetike e vitit 2017, si rezultat i së cilës dy ndërmarrjet e sistemit energjetik (KESH dhe OSHEE) u

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 6 SHTATOR 2018

detyruan të importojnë sasi të mëdha energjie me kosto më të lartë se energjia e gjeneruar në vend, kjo ndikoi në uljen e rezultatit financiar të tyre dhe rrjedhimisht edhe në kontributin fiskal në buxhet, i cili u reflektua në vitin 2018 pas depozitimit të buxhetit.

Në këtë akt normativ janë parashikuar disa ndryshime dhe lëvizje brenda zërave të të ardhurave tatimore, me qëllim reflektimin e fakteve që kanë ndodhur dhe nxitjen e punës për përmirësimin e situatës në lloje të caktuara të të ardhurave buxhetore.

Shpenzimet e përgjithshme për gjashtëmujorin e vitit 2018 janë realizuar në masën 43,2% të planit vjetor. Shpenzimet e kryera gjatë kësaj periudhe kanë mbështetur reformat e ndërmarra nga qeveria në të gjithë sektorët e ekonomisë, në përputhje me interesat e qytetarëve për përmirësimin e nivelit të jetesës së tyre.

Papunësia është në nivelin më të ulët historik në 12,5% dhe në terma vjetorë ulje me 1,7%; eksportet e mallrave u rritën me 16,7 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, ndërsa importet u rritën me 4,8 % dhe konkretisht makineritë dhe pajisjet me 9,3%.

Akti normativ i buxhetit të vitit 2018 do të sjellë nxitjen e mëtejshme të investimeve publike dhe nuk do të ketë ndryshime në nivelin e të ardhurave, si dhe të deficitit.

Në kushtet kur ky akt normativ është në mbështetje të Kushtetutës dhe në kushtet kur ndryshimet e paraqitura sigurojnë miradministrimin e financave publike dhe mbështesin nevojat e ekonomisë së vendit dhe rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve publike, të nderuara kolege dhe kolegë deputetë, ju ftoj ta miratojmë atë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Dhima!

Fjalën e ka deputetja Milva Ekonomi, për të vijuar më pas me shprehjen në emër të grupeve parlamentare.

Milva Ekonomi – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Për ne, socialistët, rritja ekonomike cilësore, inteligjente dhe gjithëpërfshirëse mbetet gjithmonë një burim për përmirësimin e jetesës së qytetarëve.

Gjatë këtij mandati qeveria socialiste vazhdon angazhimin e saj me shumë prioritet për të vazhduar konsolidimin makroekonomik të vendit, për të rritur punësimin, për të mbështetur shtetasit në nevojë, për të zhvilluar infrastrukturën, bujqësinë, agroindustrinë dhe turizmin. Pikërisht këtë rritje qeveria socialiste synon ta shtrijë në çdo cep dhe në çdo familje të vendit.

Edhe pse opozita po kopjon në mënyrë të shëmtuar mënyrën se si qaset qeveria socialiste ndaj zonave të ndryshme të vendit dhe familjeve që jetojnë në to, nuk e justifikon dot sot mosprezencën në seancën parlamentare, ku ne po marrim përsipër dhe po angazhohemi për të përmbushur më mirë nevojat për zhvillimin infrastrukturor të vendit dhe nevojat e familjeve që jetojnë në këto zona.

Sot jemi mbledhur për të diskutuar aktin normativ “Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018””. Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Stafi i Ministrisë së Financave ka këqyrrur me shumë kujdes të gjithë veprimtarinë financiare të vendit për këtë periudhë dhe ka kuptuar se angazhimi me burimet financiare që kemi për të pasur një ekonomi të konsoliduar, që ndjek nevojat që ka popullsia në të gjitha zonat gjeografike, përpiket të sjellë këtu vëmendjen te ndryshimi i disa zërave buxhetorë, në mënyrë që të plotësojë edhe më mirë nevojat që ka konsolidimi fiskal.

Ministria e ka bërë rishikimin e buxhetit duke pasur parasysh nevojën për shpërblim të pensionistëve dhe familjeve në nevojë në fund të vitit; për të rialokuar fonde për ato projekte investimesh publike, që kanë pasur ecuri të mirë gjatë kësaj periudhe për t'i çuar më parë investimet në këta sektorë, gjithashtu, edhe për të siguruar rritjen e treguesve të buxhetit.

Ajo që është shumë e rëndësishme për t'u theksuar sot është se në momentin kur Ministra e Financave merr përsipër të bëjë këto ndryshime në buxhet (natyrisht këto nevoja lindin duke parë edhe ecurinë e deritanishme të ekonomisë) është për t'u përshëndetur fakti që rritja e deritanishme ekonomike, rritja e PBB-së në periudhën e parë të vitit ka dëshmuar se është më e lartë se ajo e vitit të kaluar.

Është për t'u përshëndetur fakti që papunësia ka shkuar në nivele më të ulëta, në krahasim me vitin 2012.

Është për t'u vlerësuar fakti se edhe eksportet në Shqipëri janë rritur ndjeshëm dhe se turizmi ka pësuar një bum.

Të gjitha programet që kanë të bëjnë me rritjen ekonomike të zonave të caktuara, si për shembull ato që lidhen me agroturizmin dhe me sigurinë ushqimore të zonave, janë projekte që kërkojnë investime të studiuar mirë. Ministria e Financave ia ka dalë, në bashkëpunim me ministrinë e linjës, të përcaktojë se ku ka nevojë për këto rialokime.

Të mos harrojmë asnjëherë se gjatë kësaj periudhe numri i turistëve në vend u rrit edhe për shkak të nismës për të mbajtur pastër Shqipërinë. Ndaj edhe nevoja për të pasur një përpunim më të mirë të mbetjeve nëpërmjet investimeve publike kërkon që buxheti të rishikohet drejt dhe burimet të përdoren për këto qëllime.

Përveç kësaj është shumë e rëndësishme të theksojmë se veprimtaria e deritanishme e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për sa u takon rialokimeve buxhetore ka qenë një veprimtari, e cila e ka ndjekur nga afër edhe zhvillimin e projekteve në nivel rajonal, duke pasur parasysh se bujqësia mbetet një sektor i rëndësishëm, që ka nevojë më shumë për investime të studiuar, sidomos në fushën e ujësjellës-kanalizimeve. Këto angazhime që janë në programin tonë të zhvillimit të vendit, janë diskutuar dhe janë konsideruar edhe në zonat e ndryshme, në të cilat bëhej fjalë për t'u alokuar këto investime. Fakti që ne kemi një rritje ekonomike të studiuar mirë dhe fakti që këto shpenzime, që janë kryer deri tani, janë ndjekur me përpikëri nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe po vijnë këtu për t'u rishpërndarë në zëra buxhetorë, si dhe fakti që diferenca midis zërave do të vazhdojë të jetë zero, besoj se janë një dëshmi e qartë e angazhimit për ta çuar më përpara zhvillimin ekonomik të vendit. Ndaj unë u bëj thirrje kolegëve që ta miratojmë njëzëri këtë akt normativ për të qenë më të sigurt në rrugën e zhvillimit ku e kemi futur Shqipërinë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Ekonomi!

Këtu mbyllem diskutimet sipas listës së regjistruar. Kalojmë në diskutimet në emër të grupeve parlamentare.

Fjalën e ka deputeti Anastas Angjeli në emër të Grupit Parlamentar të PS-së!

Anastas Angjeli - E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Diskutimi i sotëm për këtë dokument kaq të rëndësishëm, edhe pse jemi në mes të vitit, u jep përgjigje disa pyetjeve. A duhet të bëjmë një ndryshim në ligjin “Për buxhetin e shtetit”? Nëse e bëjmë, pse po e bëjmë? Si? Mbi ç’bazë ligjore e bëjmë atë? Në çfarë klime ekonomike dhe financiare po e marrim iniciativën për ta ndryshuar ligjin “Për buxhetin e shtetit”? Çfarë sjell ky ndryshim për ekonominë? Çfarë sjell ky ndryshim për financat publike? Çfarë sjell ky ndryshim për aktorët dhe faktorët, që i kanë të pleksura interesat në këtë dokument kaq të rëndësishëm ekonomik, financiar, juridik dhe social të vendit?

Natyrisht, ka edhe një sërë elementesh të tjera. Duke u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, s'bëjmë gjë tjetër veçse u japim përgjigje njëherësh edhe të gjitha dilemave apo problematikave (pse jo edhe false), të ngritura herë pas here nga opozita apo nga kushdo tjetër.

Duke u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, dua të them që në fillim se praktika e ndryshimit të buxhetit të shtetit një herë në mes të vitit e ndonjëherë edhe 2 herë, nuk është tashmë një praktikë që duhet të ndezë debat, përkundrazi, kjo është një praktikë, e cila pak nga pak është kthyer në një domosdoshmëri, për faktin se ekonomia jonë është një ekonomi e ndjeshme, e cila nuk mund të konsiderojë zhvillimet për gjysmë viti apo të perspektivës së zhvillimit të saj e ndikuar kjo nga faktorët e brendshëm të zhvillimit ekonomik, por edhe nga faktorët e zhvillimit të jashtëm, siç është faktori që u përmend këtu, ai i lëvizjes së kursit të këmbimit të euros, i cili nuk mund të mos konsiderohet.

Pse e bëjmë një ndryshim të tillë? Çfarë objektivash ka ky ndryshim? Natyrisht, ndryshimi që bëhet këtë vit në ligjin “Për buxhetin e vitit 2018” synon, së pari, një menaxhim dhe një përdorim më të mirë dhe më efikas të financave publike. Siç dihet, që në

fillim të vitit të kaluar, me miratimin e buxhetit të vitit 2018, sipas një programi të caktuar, janë orientuar fondet në projekte të caktuara, shumica e të cilave kanë performuar mirë, por ka edhe projekte, ku për arsye të ndryshme, të brendshme apo të jashtme, nuk kanë performuar sa duhet.

Si është më mirë, që këto fonde të mos i përdorim apo t'i përdorim? Si është më mirë, që këto t'i përdorim me efektivitet, apo t'i lëmë të vdekura dhe të mos i përdorim? Si ka interes ekonomia jonë, që t'i përdorim sa më shumë këto fonde dhe sa më mirë apo të mos i përdorim?

Natyrisht, ka interes që t'i përdorim dhe pikërisht këtë sjell ky dokument, këtë ndryshim, që në ato projekte ku fondet nuk janë performuar mirë dhe nuk janë përdorur, të rialokohen në ato drejtime, ku projektet kanë një përdorim me performancë më të mirë dhe japin një efektivitet më të madh. Përdorimi i tyre, pa dyshim, sjell më shumë investim, më shumë ekonomi, më shumë rritje ekonomike, më shumë punësim, më shumë taksa, më shumë sigurime shoqërore, pra sjell një zhvillim më të madh.

Si është më mirë, që ato mjete monetare, ato fonde monetare, që janë përdorur deri tani dhe që parashikohen deri në fund të vitit, mund të kursen në skema të ndryshme të përdorimit të financave publike dhe të sigurimeve shoqërore, të përdoren apo të mos përdoren? T'i orientojmë ato sipas premtimit dhe programit tone, që kemi bërë për një paketë solidariteti për të ndihmuar moshat e treta, pensionistët apo ata që kanë nevojë, apo të mos i përdorim? Natyrisht, është më mirë që t'i përdorim dhe pikërisht këtë bën dhe realizon ky projekt, ku më shumë se 3 miliardë lekë i orientojnë në një paketë solidariteti për shpërblimin e pensionistëve në fund të vitit dhe për të ndihmuar familjet në nevojë.

Projekti, duke bërë këtë analizë, bazuar në atë që theksova më sipër, duke parë se në cilat institucione janë përdorur apo ku mund të përdoren më mirë, bën edhe rialokimet e nevojshme. E gjithë kjo bëhet në kushtet e një klime ekonomike dhe financiare, e cila ka performuar mjaft pozitivisht si në treguesit makroekonomikë, ashtu edhe nga pikëpamja e vazhdimit të konsolidimit fiskal, si nga pikëpamja e rritjes ekonomike, ashtu edhe nga ajo e krijimit të vendeve të reja të punës, si nga

rritja e eksporteve, ashtu edhe nga rritja e investimeve të brendshme dhe të huaja, si nga ruajtja dhe mbajtja nën kontroll e inflacionit, ashtu edhe nga pikëpamja e luftës kundër informalitetit dhe rritjes së mbledhjes së të ardhurave dhe menaxhimit më të mirë të shpenzimeve.

Pikërisht kjo klimë pozitive ekonomike kërkon një mbështetje ligjore, siç është kjo e sotmja, që, edhe pse është me akt normativ, s'ka bërë gjë tjetër veçse është bazuar në Kushtetutë dhe në ligj dhe në të njëjtën kohë u ka dhënë qeverisë dhe institucioneve të saj mundësinë që të veprojnë në kohë për t'i menaxhuar më mirë këto fonde publike.

Për të gjitha këto arsye në emër të Grupit Parlamentar të PS-së ju ftoj ta votoni atë!

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Angjeli!

Këtu përfundon diskutimi i aktit normativ.

10 minuta pushim.

Ftoj të gjithë kolegët deputetë të mblidhen për votim!

(Drejtimit e sencës e merr zoti Ruçi.)

Gramoz Ruçi – Rifillojmë seancën.

Të hiqen kartat e deputetëve që nuk janë prezentë!

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

Janë 78 deputetë të pranishëm.

Fillojmë me aktin normativ nr.1, datë 26.07.2018 “Për disa ndryshime në ligjin nr.109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018””.

Ky akt normativ kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

Ka vetëm një votim me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

76 pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Lidhur me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, që është për votim, ky projektligji kërkon shumicë të cilësuar. Duke mos pasur kuorumin, ai shtyhet.

E njëjta gjë vlen edhe për projektligjin “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë””.

Siç është bërë tashmë publike, sot në mëngjes më ka ardhur një kërkesë nga kryetari i komisionit hetimor parlamentar, zoti Paloka. Pavarësisht nga ato që janë thënë, më lejoni të njoh Kuvendin me ecurinë e deritanishme të këtij komisioni për të arritur pastaj në vendimmarrjen e Kuvendit për zgjatjen e afatit, që është thelbi ose fundi i kërkesës.

Siç e dini, Kuvendi, bazuar në një të katërtën e anëtarëve të tij, me vendimin nr.30/2018, ka miratuar ngritjen e komisionit hetimor për të kontrolluar veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore për parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit, të trafikut të drogës, narkotikëve, përfshirë çështjen për të cilën prokuroria po heton zotin Tahiri, ish-ministër i Brendshëm, me një afat 6-mujor.

Me vendim nr.52 është ngritur komisioni, për të cilin jeni në dijeni. Sekretari i Përgjithshëm, në zbatim të vendimit të Kuvendit, ka krijuar gjithë infrastrukturën e domosdoshme.

Komisioni hetimor, nga periudha kur është ngritur dhe deri më sot, ka zhvilluar vetëm 4 mbledhje.

Në mbledhjen e parë, në datën 19.03.2018, ka bërë thjesht konstituimin dhe ka zgjedhur sekretarin e komisionit. Në mbledhjen e dytë, në datën 26, ka miratuar vetëm rregulloren e brendshme të komisionit hetimor dhe paraqitjen e planit paraprak të hetimit. Në mbledhjen e tretë është bërë paraqitja e propozimeve të planit hetimor nga anëtarët e komisionit. Në mbledhjen e katërt është bërë miratimi i listës së ekspertëve të jashtëm, të cilët asistojnë komisionin hetimor.

Këto janë mbledhjet dhe aktiviteti i këtij komisioni që nga momenti i ngritur deri më sot. Sigurisht, pretendimi i shkresës që më është drejtuar është se ka pasur mangësi në plotësimin e dokumenteve. Mund të informoj se, sipas kërkesave që ka bërë komisioni hetimor, institucionet: Kryeministria, Presidenca, Prokurori i Përgjithshëm, Shërbimi Informativ Shtetëror, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit së Klasifikuar, Gjykata e Rrethit të Tiranës, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Bujqësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Qendra Kombëtare e Biznesit dhe Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga komisioni.

Ministria e Brendshme, me shkresë zyrtare ka kërkuar kohë për dorëzimin e dokumentacionit, meqenëse është shumë voluminoz, si dhe duke bërë specifikimet konkrete të dokumentacionit për të respektuar legjislacionin për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, gjë për të cilën është parë përgjigjja nga komisioni.

Tej kësaj, pavarësisht politizimit të kërkesës dhe justifikimeve, sepse është e papranueshme që për 6 muaj një komision të mbledhet vetëm 4 herë, unë i paraqes Kuvendit projektvendimin për ta plotësuar kërkesën e kryetarit të komisionit hetimor për të kontrolluar veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore për parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit të trafikut të drogës, narkotikëve, përfshirë çështjen për të cilën prokuroria po heton zotin Tahiri, ish-ministër i Brendshëm, për zgjatjen e afatit të komisionit hetimor me 3 muaj të tjerë.

Kemi një votim me elektronikë.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 6 SHTATOR 2018

Hapet votimi.
Mbyllet votimi.
72 vota pro, 3 kundër, 2 abstenime.

Faleminderit!
Këtu mbyllet seanca e ditës së sotme.
Seanca tjetër do të njoftohet.

(Seanca u mbyll në orën 13:45.)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**